



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit i Ciklit të Dytë “Master i Shkencave” në  
“Studime Religjose”, me profile “Dialog Ndërfetar”, “Edukim  
Fetar” dhe “Leadership Fetar”**

ofruar nga

**Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar “Bedër”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Enri Hide

2. Dr. Zana Strazimiri

Korrik 2023

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për programin e studimit Master i Shkencave në “Studime Religjose”, me profile ofruar**  
**nga institucioni i arsimit të lartë Kolegji Universitar “Beder”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Beder”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Islame
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në Studime Religjose, me profile “Dialogu Ndërfetar”, “Edukim Fetar”, “Lidershipi Fetar”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 328, datë 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	V.a 2021-2022: 9 PAE / 0 PAK V.a 2022-2023: 8 PAE / 1 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a 2021-2022: 8 Studentët V.a 2022-2023: 6 Studentë
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi Master i Shkencave në “Studime Religjose” me tre profile, Dialog ndërfaqet; Edukim fetar; Lidership fetar, organizohet nga Departamenti i Shkencave Islame, pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Bedër” (KUB).

Departamenti i Shkencave Islame vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore duke synuar në vazhdimësi t’i përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë nevojës për arsimimin e përgatitjen e kuadrove fetare, në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të KUB, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si edhe duke ndjekur veçantitë dhe risitë në fushën e edukimit fetar në vend e më gjerë.

Programi MSc në “Studime Religjose” me profile, është i organizuar sipas sistemit me kohë të plotë, në dy vite akademike, i ndarë në 4 semestra dhe realizohet me 120 ECTS, në përputhje me planin mësimor të propozuar nga Departamenti i Shkencave Islame, miratuar nga Senati akademik i KU “Beder”. Studentët që përfundojnë me sukses këtë cikël studimesh të nivelit të dytë pajisen me diplomë Master i Shkencave në “Studime Religjose”, sipas profilit përkatës. Programi përmban 15 lëndë dhe tezën e diplomës në përfundim të studimeve dhe ofrohet në gjuhën angleze.

Me strukturën e përmbajtjen e tij ky program ka si objektiv edukimin e formimin e studentëve me njohuri të thelluara në fushën e studimeve islame dhe të çështjeve bashkëkohore të lidhura me to. Programi ka si qëllim të formojë ekspertë, të aftë për të punuar në organizma arsimorë, socialë, kulturorë, fetare, pranë institucioneve kërkimore dhe organizmave kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me qasje ndaj problematikave sociale e kontributit të komuniteteve fetare në nevojat e vendit dhe në dialogun ndërfaqet e ndërkulturor. Programi ka si qëllim promovimin e vlerave morale, fetare dhe shoqërore, për të formuar profesionistë e lidership, por edhe qytetarë aktivë, me mendim kritik e inovativ

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**


Raporti është përgatitur nga një grup ekspertësh të vlerësimit, njohur si Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), ngritur nga ASCAL në përputhje me dispozitat ligjore të ASCAL. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

GVJ, në vlerësimin e tij, është bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dorëzuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për programin Msc në “Studime Religjose” me profile, pranë Departamentit të Shkencave Islame të KUB, dokumentacionin shoqërues të raportit dhe në vizitën dyditore organizuar pranë këtij institucioni më 23.03.2023 dhe 24.03.2023. Po ashtu, Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, dhe udhëzimet e ASCAL-it.

Gjatë vizitës në KUB, GVJ ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e institucionit të përfshirë në këtë proces: me strukturat drejtuese të fakultetit dhe departamentit që ofron programin e studimit nën vlerësim, me stafin akademik të programit, me përfaqësues të zyrave menaxheriale dhe horizontale të burimeve njerëzore, sekretarisë mësimore, NJSBC, bibliotekës, si dhe me studentë të programit.

Ecuria e procesit është koordinuar nga koordinatori i ASCAL-it, i cili ka asistuar GVJ-në dhe ka koordinuar procesin e mbledhjes së dokumentave dhe vënien në dispozicion të GVJ.

Më datë 21.07.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 81/25 Prot., datë 21.07.2023, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 27.07.2023, institucioni ka dërguar përgjigje mbi draft raportin, duke u shprehur se nuk ka komente, si rrjedhojë raporti, merr formen përfundimtare, si raport i vlerësimit të jashtëm.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në  
“Studime Religjose” me profile “Dialog Ndërfetar”; Edukim Fetar”;  
“Lidership Fetar”.**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Në statutin e KUB theksohet se misioni i institucionit është përgatitja e individëve të kualifikuar nëpërmjet një filozofie edukimi që synon vënien në jetë të ideve e projekteve që i shërben progresit shoqëror të vendit. Me programet e studimit që ofron, institucioni kontribuon në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit. Përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor me standarte të larta, synohet përgatitja e studentëve me dije të nivelit bashkëkohor.</p> <p>Programi i studimit ofrohet në shërbim të interesave kombëtare, i bazuar në statutin e institucionit, ku paraqitet vizioni për t'i shërbyer zhvillimit të dijes në shoqërinë shqiptare, nëpërmjet realizimit të një procesi cilësor edukimi. Traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore konsiderohen si baza e mësimdhënies dhe e kërkimit shkencor, ndërthurur me standartet dhe arritjet më të mira ndërkombëtare. Nëpërmjet edukimit dhe forcimit të vetëdijes humane, fetare, kombëtare, kulturore, etike dhe identitare të studentit, programi reflekton interesat dhe përparësitë kombëtare të vendit për edukimin e tolerancës dhe bashkëekzistencës fetare, frymës së mirekuptimit fetar e kulturor, harmonise e bashkëjetesës paqësore në shoqëri.</p> <p>Ky program studimi ofron risi në ofertën akademike shqiptare, pasi i shërben ruajtjes dhe promovimit të interesave dhe vlerave kombëtare duke edukuar e kultivuar tek studentët vlerat më të mira të traditës islame në Shqipëri, në trojet shqiptare e më gjërë, historinë, kontributet e vlerat e saj për realitetin bashkëkohor e atë shqiptar, në drejtim të forcimit të paqes e bashkëjetesës ndërfetare, të nxitjes së dialogut ndërfetar dhe luftës kundër ekstremizmit e radikalizmit në tërësi</p> <p><i>[Ev.2: Statuti i KU “Beder”; Ev.1: Mendimi i Dekanit; Ev.8: Plani Strategjik Institucional 2018-2023]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sylabuseve të lëndëve e nga takimi me stafin akademik të programit të studimit, rezulton se programi është në përputhje me objektivat dhe misionin e KUB, për përgatitjen e

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>profesionistëve të kualifikuar në fushën e studimeve religjioze. Programi ka në fokus edukimin e formimin e studentëve me njohuri të thelluara në fushën përkatëse me tre profilet që ofrohen, në problematikat e sfidat e aktualitetit të lidhura me to.</p> <p>Programi synon zhvillimin e mendimit kritik dhe kultivimin e aftësive të nevojshme për të realizuar kërkime shkencore në fusha e aspekte të ndryshme të studimeve islame, dialogut ndërfaqetor, edukimit e lidershit fetar, por edhe më gjerë, në disiplina të tjera sociale.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.2: Statuti i KU “Beder”; RVB; Ev.55: Sylabuset e lëndëve të programit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i sylabuseve të programit, strategjisë së përgjithshme të KUB, nga njohja me statutin dhe rregulloren themelore të institucionit, rezulton se ky program studimi ofrohet në përputhje dhe në zbatim të dokumentacionit themelor e objektivave strategjike të institucionit.</p> <p>Programi është konceptuar në përputhje me qëllimin strategjik për formimin e studentëve të përgatitur për sfidat e ardhshme, për t’i edukuar ata më fort me shprehje praktike, për një përshtatje më të mirë me mjedisin e ardhshëm të punës e për rritjen e përvojave ndërkombëtare të tyre.</p> <p>Thellimi, nëpërmjet këtij programi studimi, në fushën e studimeve religjioze dhe synimi për të edukuar e konsoliduar një status të ri të teologut në kushtet dhe zhvillimet e reja ekonomike, politike dhe shoqërore të vendit, u përgjigjet alternativave konkrete që lidhen me situatën fetare në Shqipëri. Ky program studimi i shërben detyrës për të kontribuar në forcimin e mjedisit të paqes e bashkëjetësës ndërfaqetare në Shqipëri e luftës ndaj çdo forme të ekstremizmit e radikalizimit fetar.</p> <p>Në përputhje me planin strategjik institucional, programi synon të përgatisë jo vetëm të diplomuar të suksesshëm e me aftësi të thella profesionale, ekspertë që përmbushin kërkesat e tregut të punës, por edhe individë me cilësi të larta morale dhe shoqërore, që shërbejnë si modele frymëzues dhe motivues në shoqëri. Programi u përgjigjet edhe objektivave e misionit të institucionit në drejtim të aftësisimit shkencor të studentëve, duke krijuar baza të qëndrueshme njohurish edhe për studimet e ciklit të tretë të doktoratës.</p> <p><i>[Ev.2: Statuti i KU “Beder; Ev.8: Plani Strategjik Institucional 2018-2023; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit; Ev.5: Rregullorja e KU “Beder”]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin</p>	<p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se programi është konceptuar me synimin e përgatitjes së studentëve në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, me ecurinë e pritshme të ekonomisë së vendit e tendencave të saj, me përprjekjet për integrimin në BE dhe me interesin kombëtar në tërësi.</p>

përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	<p>Programi synon të kultivojë tek studentët vlerat më të mira të traditës islame në Shqipëri, të kontributit e rolit të saj në realitetin shqiptar e atë bashkëkohor në tërësi në drejtim të forcimit të paqes e bashkëjetesës ndërfetare, të nxitjes së dialogut ndërfetar dhe luftës kundër ekstremizmit e radikalizmit në tërësi.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.55: Sylabuset e lëndëve të programit të studimit; Ev.1: Mendimi i Dekanit; Ev.8: Plani Strategjik Institucional 2018-2023]</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit reflekton interesat dhe përparësitë kombëtare të vendit për edukimin e tolerancës dhe bashkëekzistencës fetare, frymës së mirekuptimit fetar e kulturor, harmonisë e bashkëjetesës paqësore në shoqëri.</i></p> <p><i>Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se programi është konceptuar me synimin e përgatitjes së studentëve në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, me ecurinë e pritshme të ekonomisë së vendit e tendencave të saj, me përpjekjet për integrimin në BE dhe me interesin kombëtar në tërësi.</i></p> <p><i>Programi synon të kultivojë tek studentët vlerat më të mira të traditës islame në Shqipëri, të kontributit e rolit të saj në realitetin shqiptar e atë bashkëkohor në tërësi.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Islame, pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, me përvojë në mësimdhënie si dhe me burimet e kapacitetet e duhura akademike për zhvillimin e tij, bazuar kjo mbi të dhënat e sjella nga vetë institucioni. Në planin strategjik të institucionit, theksohet si objektivi themelor realizimi i një procesi cilësor arsimimi i studentëve si dhe nxitja e mbështetja e një komuniteti të suksesshëm e ndërveprues kërkuesish shkencorë, duke promovuar praktikatat më të mira të mësimdhënies dhe veprimtarisë shkencore.</p> <p>Nga biseda me dekanin dhe drejtuesin e departamentit si dhe shqyrtimi i CV-ve të stafit mësimor, konstatohet se institucioni ka angazhuar në këtë cikël studimi personel të kualifikuar, me tituj dhe grada shkencore, duke aplikuar gjithashtu edhe module me lektorë të ftuar.</p>

	<p>Në mbështetje të synimit për t'i dhënë institucionit një profil ndërkombëtar, me studentë nga trevat shqipfolëse e diasporës por edhe nga vende të tjera të Europës e më gjerë, në planin strategjik të institucionit vihet në dukje edhe profili ndërkombëtar i stafit akademik, që përforcohet me marrëveshje bashkëpunimi me universitete e kompani ndërkombëtare. Aktualisht, pjesë e këtij programi janë një numër studentësh të huaj e nga trevat shqipfolëse.</p> <p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton përpjekja e institucionit në drejtim të aftësimit e kualifikimit shkencor të stafit, me një bilanc të konsiderueshëm aktivitetesh kombëtare dhe ndërkombëtare, konferenca, seminare, trajnime e specializime, botime shkencore e pjesëmarrje në projekte kërkimore. Personeli me kohë të plotë i angazhuar në këtë program studimi, përbërë mbi 70% të personelit akademik të angazhuar në realizimin e programit, ndërsa në hartimin e tij është marrë parasysh emërtimi në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës, Ev.8: Plani Strategjik i KU “Beder” 2018-2023; RVB, Ev.16: CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konstatohet se ky program studimi, që i takon fushës së shkencave humane, është ingranuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet qëllimi i programit për një përgatitje të përparuar akademike të studentëve në fushën e shkencave bashkëkohore të fesë islame, por edhe në qasjen ndaj problematikave sociale e kontributit të komunitetit Islam në nevojat e vendit dhe në dialogun ndërfetar e ndërkulturor.</p> <p>Programi është konceptuar si harmonizim njohurish, i atyre me bazë teorike të fushës dhe ndihmëse, duke vazhduar me thellim në fushat specifike. Hartimi dhe organizimi i programit në fushën e studimeve religjioze mbështetet në direktivat e udhëzimet institucionale të organizmave përgjegjës të vendit e ato ndërkombëtare.</p> <p><i>[Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame; Ev.7: Rregullore e programit MSc në “Studime Religjioze”; Ev.67: Vendim i Këshillit të Ministrave nr.310, datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi studimi, është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë, Departamentit të Shkencave Islame, përgjegjës për programin e studimit.</p>



programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	<i>[Ev.7: Rregullore e programit të studimit; Ev.5: Rregullorja Themelore e KU "Beder"; Ev.55: Sylabuset e lëndëve të programit; Ev.6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë].</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Departamenti i Shkencave Islame nuk ofron "Master professional".  <i>[RVB]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Senati Akademik i KUB ka miratuar rregulloren e praktikës profesionale, në bazë të të cilës është organizuar procesi i trajnimit profesional të studentëve. Studentët kanë mundësi të zhvillojnë praktikat e tyre profesionale, sipas marrëveshjeve me institucionet pritëse, në të gjitha dikasteret e KMSH, pranë drejtorive të saj në selinë qendrore, filialet në rrethe si myftinitë, shkollat, kurset dhe medresetë ku zhvillohen lëndë të Shkencave Islame. Gjithashtu, praktikat mund të zhvillohen edhe pranë revistave, medias, radios "Spektrum" në varësi të KMSH, jashtë vendit, në institucionet islame në diasporë e më gjerë. Veç praktikave, institucioni i kushton rëndësi edhe punësimit të studentëve në vazhdimësi, nëpërmjet zyrës së planifikimit të karrierës që bashkëpunon me njësinë bazë, si dhe nëpërmjet zyrës të të diplomuarve që koordinon lidhjen e tyre me punëdhënësit.  <i>[RVB; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame; Ev.58: Studim Tregu i Departamentit të Shkencave Islame; Ev.60: Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e praktikave profesionale]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi studimi është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë, Departamentit të Shkencave Islame, përgjegjës për programin e studimit, si edhe me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë. Programi është konceptuar si harmonizim njohurish, i atyre me bazë teorike të fushës dhe ndihmëse, duke vazhduar me thellim në profilet specifike, ndërsa personeli i angazhuar mban tituj dhe grada shkencore sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, me një bilanc të konsiderueshëm aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare e botimesh shkencore. Nga dokumentacioni vihet në dukje edhe profili ndërkombëtar i stafit akademik, ndërsa pjesë e këtij programi janë një numër studentësh të huaj e nga trevat shqipfolëse.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me drejtuesit e njësisë kryesore e asaj bazë si dhe përfaqësuesit e zyrave menaxheriale të institucionit, bazuar edhe në shqyrtimin e dokumentacionit, konstatohet se programi i studimit realizohet në kushtet e ndarjes së detyrave e përgjegjësisë mes njësisë dhe personelit. Rregullorja e institucionit e aktet e brendshme dispiplinojnë institucionalisht marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda tij, duke përcaktuar rolet e përgjegjësitë përkatëse të personelit akademik, ndihmës-mësimor e administrativ në nivel bashkëpunimi e koordinimi dhe në përputhje e në shërbim të programit të studimit.</p> <p>Njësia bazë, që mban peshën kryesore për mbarëvajtjen e programit, monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e mbarëvajtjen e programit, nëpërmjet analizave periodike, formave e metodave vlerësuese e vetëvlerësuese.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame; Ev.26: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë mësimore; Ev.28: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC; ev.2: Statuti i KU "Beder"; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit MSc në "Studime Religjioze"]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës të institucionit, rezulton se në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, KUB u ka kushtuar rëndësi të veçantë marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe brenda e jashtë vendit e aktorëve të tjerë të interesuar, që u mundësojnë studentëve zhvillimin e praktikave profesionale me perspektivë edhe punësimi. Bëhet fjalë për institucionet në varësi të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, si myftini, medrese, kurse dhe qendra kulturore në Shqipëri dhe diasporë, etj. Këto praktika u sigurojnë studentëve një përvojë të rëndësishme për aplikimin e studimeve të tyre teorike gjatë formimit universitar.</p> <p>Janë realizuar programe trajnuese e shkolla verore në bashkëpunim me universitete të huaja, si: Universiteti i Vjenës në Austri, Universiteti el Ez'her dhe Universiteti i Kajros në Egjipt, Universiteti Haifa në Izrael, Universitetin Tor Vergata në Itali, me një peshë të rëndësishme në fushën akademike ndërkombëtare në studimet Islame.</p> <p>Në bazë të planit të veprimtarive të departamentit, në mbështetje të forcimit cilësor të mësimdhënies e mësimnxënies, për ciklin e dytë të studimeve janë organizuar, në mënyrë periodike, konferenca shkencore, panele, seminare, simpoziume dhe aktivitete ndërfetare, leksione të</p>

	<p>hapura e forma të tjera të veprimtarive shkencore, me pjesmarrje të stafit akademik e studentëve.</p> <p><i>[Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame; Ev.58: Studim tregu i departamentit të Shkencave Islame; Ev.60: Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera për realizimin e praktikave profesionale]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga bisedat me drejtuesit e institucionit, rezulton se KUB ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh të posaçme me institucione të ndryshme, duke u dhënë mundësi studentëve jo vetëm të zhvillojnë praktikat profesionale, por të krijojnë dhe ura lidhëse me tregun e punës; një pjesë e mirë e tyre punësohen në institucionet ku kanë zhvilluar praktikën. Institucioni, nëpërmjet marrëveshjeve, garanton edhe procesin mbikqyrës të praktikës nga ana e punëdhënësve.</p> <p>KUB ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve jashtë vendit, ndërsa ka marrëveshje bashkëpunimi në një numër të konsiderueshëm, me institucione arsimore brenda vendit dhe të huaja, për organizim të përbashkët të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, projekteve kërkimore, trajnimeve profesionale dhe stazheve studentore.</p> <p>Një traditë të mirë bashkëpunimi të frytshëm në fushën e studimeve religjioze Departamenti i Shkencave Islame ka me Institutin Katolik të Shkodres dhe Kolegjin Universitar “Logos”, me organizimin e leksioneve të hapura e simpoziumeve të përbashkëta ndërfaqetare me tematika që i shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe fushës mësimore e shkencore të programit.</p> <p><i>[Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame; Ev.37: Raporti vjetor i KU “Beder”; Ev.60: Lista e institucioneve me të cilat KU “Beder” ka marrëveshjeve partneriteti për bashkëpunime në fusha të ndryshme; Ev.64: Plani i aktiviteteve të departamentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Islame harton në mënyrë periodike raporte, siç janë ato vjetore, që i referohen analizës së ecurisë së programeve të studimit me indikatorët përkatës, duke evidentuar edhe marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të tyre. Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit përkatës, rezulton se lidhur me zhvillimin e praktikës, institucioni ka hartuar një anketë vetëvlerësimi me studentët e programit të studimit, ku jepet mendimi për komponentë të ndryshëm që lidhen me zhvillimin e tij, ndër të tjera, aty figuron edhe kërkesa për vlerësimin e efektivitetit të praktikave profesionale, bazuar në njohuritë e marra në auditor si dhe kërkohen sugjerime për t’i përmirësuar ato.</p> <p>Jemi të mendimit se lidhur me zhvillimin, ecurinë e përfitimet e praktikës profesionale, institucioni mund të hartojë një dokumentacion me të</p>

	hollësishëm e indikativ. (ditari, vlerësimi i punëdhënësit, komente të nevojshme e sugjerime nga palët e pedagogu mbikqyrës)			
	<i>[Ev.19: Anketa me studentët e programit të studimit; Ev.17: Raporti përmbledhës i vetëvlerësimit të departamentit; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame; Ev.37: Raporti vjetor i KU "Beder"]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës të institucionit, rezulton se, në funksion të realizimit të objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, KUB u ka kushtuar rëndësi të veçantë marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe brenda e jashtë vendit e aktorëve të tjerë të interesuar, që u mundësojnë studentëve zhvillimin e praktikave profesionale me perspektivë edhe punësimi.</i></p> <p><i>KUB ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve, të organizimit të programeve trajnuese e shkollave verore në bashkëpunim me universitete të huaja, konferencave shkencore, etj.</i></p> <p><i>Departamenti i Shkencave Islame harton raporte periodike, që i referohen analizës së ecurisë së programeve të studimit me indikatorët përkatës.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregulatore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se ky program studimi është i organizuar në përputhje me sistemin ECTS dhe kriteret e përcaktuara. Gjithashtu programi është bazuar në Kartën e Bolonjës, që përcakton ndarjen e grupimin e lëndëve në kurrikulën e programit. Programi është i ndarë në dy vite, katër semestra, ku studentët realizojnë jo më pak se 1500 orë pune në vit. Nga pikëpamja e shpërndarjes së krediteve dhe orëve të punës, ngarkesa korresponduese e një krediti është 25 orë mësimore. Struktura e programit nxjerr në pah një semestër të organizuar në 16 javë

	<p>mësimore, të cilat në varësi të nevojave të stafit pedagogjik organizohen si javë mësimore, testimi, apo seminaresh.</p> <p>Çdo lëndë është e organizuar në leksione dhe seminare, ndonëse i është lënë hapësirë relative çdo pedagogu për organizimin autonom të lëndës së tij, në bazë të nevojave specifike, çka përputhet me nevojat shkencore të një mësimdhënieje në masterin shkencor.</p> <p><b>[Ev. RVB]</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Ndërtimi i këtij programi studimi synon formimin e njohurive specifike në Studime Religjioze (sipas tre profileve). Bazuar në programin e studimit, lëndët e zhvilluara dhe ndërthurjen midis lëndëve dhe profileve, ai arrin të ofrojë njohuri për një larmi të gjerë profesionesh, sipas secilit profil.</p> <p>Lëndët e programit ofrojnë njohuri të avancuara teorike të fushës, të cilat të ndërthurura me praktikën dhe seminare të përbashkëta të pajisin studentët me shkathtësi për zgjidhjen e problemeve komplekse në studime religjioze.</p> <p>Programi i pajis studentët me njohuri të avancuara, si dhe me metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe të veçanta që lidhen me religjiozitetin, filozofinë e feve, etj.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit ka përcaktuar ngarkesën e Praktikës Profesionale në 12 kredite, ndërsa detyrimet përmbyllëse përfshijnë Punimin e Diplomës.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Kriteri 4 nuk aplikohet, pasi programi i studimit Master i Shkencave në shqyrtim është në Studime Religjioze, jo Mësuesi.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të</p>	<p>Kriteri 5 nuk aplikohet, pasi programi i studimit Master i Shkencave në shqyrtim është në Studime Religjioze, jo Mësuesi.</p>

mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
<b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	<p>Organizimi i këtij programi studimi është në përputhje me kuadrin ligjor. Ai organizohet në 120 ECTS dhe ndahet në disiplina të njohurive të formimit të përgjithshëm, në lëndë të disiplinës së programit (lëndë profili), lëndë që vijnë nga disiplina të ngjashme, njohuri formuese shtesë (si gjuhë e huaj dhe informatikë). Pranimi i studentëve rezulton se bëhet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, sipas kriterëve të detajuara, ku kandidatët për t'u bërë pjesë e tij plotësojnë një dosje me të gjitha kriteret specifike.</p> <p>Financimi i programit bëhet në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe specifikat përkatëse të parashtruara nga ministria përkatëse për arsimin, nëpërmjet pagesave të studentëve dhe financimit ose mbështetjes financiare të pjesshme ose të plotë për studentët ekselentë.</p> <p><i>[Ev. RVB]</i></p>
<b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Ky program studimi nuk ka ngjashmëri me programe të tjera në të njëjtën fushë studimi ose me të njëjtën emërtesë. Për rrjedhojë, ky kriter është i pazbatueshëm në këtë rast.
<b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Të gjitha programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Shkencave Islame shoqërohen me kodin përkatës dhe janë organizuar në përputhje me klasifikimin dhe kodifikimin e kërkuar nga MAS.
<b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk mund të aplikohet për këtë program studimi, pasi nuk kemi të bëjmë me një program të përbashkët mes dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë.
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se programi i studimit është i organizuar në përputhje me sistemin ECTS dhe kriteret e përcaktuara.</i></p> <p><i>Organizimi i programit të studimit është në përputhje me kuadrin ligjor.</i></p> <p><i>Lëndët e programit ofrojnë njohuri të avancuara teorike të fushës, të cilat të ndërthurura me praktikën dhe seminarët tentojnë të pajisin studentët me shkathtësi për zgjidhjen e problemeve komplekse në studime religjioze, sipas secilit profil.</i></p> <p><i>Programi i pajis studentët me njohuri të avancuara, si dhe me metoda e parime shkencore të përgjithshme dhe të veçanta për secilin profil.</i></p>

	<p><i>Një pjesë e kriterëve që plotësojnë këtë standard nuk janë të aplikueshme, pasi u referohen programeve të përbashkëta, ngjashmërive me programe të tjera, etj.</i></p> <p><i>Në përfundim, kriteret e kërkuar brenda këtij standardi gjykohet se përmbushen plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>	
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë ka në përbërje të tij katër njësi bazë, ku secila prej tyre ka minimum 7 anëtarë personel akademik dhe ku minimalisht 3 prej tyre mbajnë gradën shkencore Dr., kjo në përputhje me ligjin e arsimit të lartë.</p> <p>Njësia kryesore bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Departamenti i Shkencave Islame. Struktura e saj rezulton e plotë, me drejtuesin dhe pedagogët me kohë të plotë. Ka minimalisht 7 anëtarë të personelit akademik dhe 3 prej tyre me gradën Dr.</p> <p><i>[Ev. RVB fq. 12-13; Ev. Nr. 3: Rregullorja e organizimit akademik. Ev. Nr. 59: Numri i personelit akademik për çdo njësi të fakultetit.]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Programi në nivel departamenti rezulton se ka angazhuar personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave. Për këtë veprimtari angazhohen të paktën dy pjesëtarë të stafit të cilët ndjekin në vazhdimësi praktikën e studentëve. Ndërkohë personel ndihmës administrativ është angazhuar në vijimësi për procesin e dokumentimit të praktikave mësimore. Këto angazhime stafit akademik ndihmës i njihen si ngarkesë në kuadrin e përgjithshëm vjetor, ndërsa atij administrativ në kuadrin e detyrimeve që rrjedhin nga përshkrimi i punës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Islame, si njësia kryesore përgjegjëse për çdo program studim ka përcaktuar në Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve (Neni 10) një koordinator për zhvillimin e programit. Sugjerohet ndërtimi i një sistemi dokumentimi i praktikës sipas formularëve përkatës dhe raportit final, në format të unifikuar.</p> <p><i>[Rregullorja e Studimeve, Neni 10]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion dhe vizita në terren, rezulton se institucioni ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në ligj për</i></p>

	<p>organizimin dhe strukturën akademike, ka angazhuar personel akademik dhe ndihmës për mbikëqyrjen e praktikave mësimore.</p> <p>Sugjerohet ndërtimi i një sistemi dokumentimi i praktikës sipas formularëve përkatës dhe raportit final, në format të unifikuar.</p> <p>Ky standard përmbushet plotësisht, për të treja kriteret e tij.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Sa i përket strukturës së programit, institucioni disponon dhe ka vënë në dispozicion të GVJ-së të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Ndër to përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregullorja themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”</li> <li>- Rregullorja e programit të studimit</li> <li>- Rregullorja e sekretarisë mësimore</li> <li>- Struktura e programit</li> <li>- Përmbajtja e lëndëve (silabuset).</li> </ul> <p>Nga verifikimi rezultoi se të gjitha këto informacione janë gjithashtu të publikuara online dhe të aksesueshme nga publiku i gjerë dhe studentët e institucionit përmes faqes së dedikuar personale të tyre (për silabuset).</p> <p><i>[Ev. 6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Ev. Programi i studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi mësimor përfshin informacione mbi ngarkesën mësimore në kredite, ndarjen e lëndëve në semestra si dhe orët brenda e jashtë auditorit. Frekuentimi është i nivelit 80%, për programet e ciklit të dytë të studimeve. Kjo rezultoi jo vetëm nga Rregullorja por edhe nga diskutimet me pedagogë e studentë gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Institucioni rezulton se ka zbazuar strategjinë e vlerësimit të vazhdueshëm të dijeve, duke i shpërndarë pikët e grumbulluara nga çdo student gjatë gjithë semestrit në përpjesëtimin 10% pjesëmarrje; 30-40% testime (të pjesshme gjatë semestrit); 50-60% provim përfundimtar. Megjithatë rezultoi se një pjesë e pedagogëve kishin fleksibilitet për vlerësimin e studentëve, në varësi të llojit të lëndës që ofronin.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka specifikuar të gjitha kriteret e pranimit, të përgjithshme dhe specifike, që lidhen me programin e studimit. Këto specifikohen në Rregulloren e Përgjithshme.</p> <p>Gjithashtu janë përcaktuar edhe kriteret e transferimit të studentëve në një rregullore të veçantë për transferimet.</p>



	Të dyja këto rregullore janë të miratuara në Senat. Kriteret janë të publikuara online dhe janë të aksesueshme edhe për publikun e gjerë.			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Ky program studimi përfshin informacionet e nevojshme për lëndët. Të gjitha lëndët rezultuan me silabusin e tyre. Silabusi është i organizuar në mënyrë të qartë, me një format të unifikuar, i cili gjithsesi ka nevojë të standardizohet dhe unifikohet më tej. Silabuset përmbajnë të gjithë programin sipas javëve, ku literatura është e ndarë në të detyrueshme dhe opsionale. Silabuset përmbajnë përmbledhjen e lëndës, kreditet, konceptet themelore, temat specifike, formën e kontrollit të dijeve dhe të gjitha informacionet e tjera të nevojshme. Formatet janë të miratuara në nivelin e senatit në përputhje me aktet nën ligjore në fuqi.  <i>[Ev. 55: Syllabuset e lëndëve]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Nga diskutimet me pedagogët dhe shqyrtimi i RVB-së, rezultoi se përmbajtja e programit përditësohet në mënyrë periodike, në fillim të çdo viti akademik (si dhe në disa raste në fillim të çdo semestri). Ndryshimet janë të miratuara nga drejtuesi i Departamentit.  <i>[Ev. Minutat e takimit; RVB]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni disponon dhe ka vënë në dispozicion të GVJ-së të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Rezultoni se përmbajtja e programit përditësohet në mënyrë periodike. Institucioni ka specifikuar të gjitha kriteret e pranimit, të përgjithshme dhe specifike, që lidhen me programin e studimit. Silabusi është i organizuar në mënyrë të qartë, me një format të unifikuar. Standardi rezultoi se përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.4</b> <b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të	Për nga vetë natyra e këtij programi studimi, emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive e orientojnë përgatitjen teorike dhe praktike të studentëve kah një tërësi fushash teologjike që mundëson domosdoshmërisht thellimin e njohurive në dialogun ndërfaqor dhe edukimin dhe liderhipin fetar. Ndërkaq, tregu i punës i identifikuar për këtë grup të diplomuarish nuk shtrihet vetëm në fushën e tyre të studimeve, por edhe në sektorë të

<p>mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>tjerë, si administrata publike, institucionet kërkimore, OJF-të, sektori qeveritar i politikëbërjes specifike, institucionet e kultit, apo edhe në vijim në studime doktorale.</p> <p>Lëndët janë harmonizuar mjaftueshëm për të ofruar qasjen drejt këtij objekti. Praktikrat e studentëve kryhen në institucione shtetërore, qendra kërkimore dhe institucione kulturi, duke u ndërthurur mjaftueshëm çka u konstatua më sipër.</p> <p><i>[Ev. 55 Syllabuset e lëndëve; RVB; Ev. nr. 58 Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave Islame]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Lëndët e këtij programi ndërthurin qartazi objektivat e tyre mësimorë dhe akademike duke mundësuar arritjen e objektivave të programit.</p> <p>Llojet e ndryshme të lëndëve që ndërthuren (formim i përgjithshëm, karakterizues, disiplina integruese, njohuri formuese), e arrijnë gjithashtu këtë objektiv.</p> <p>Lëndët ndërthurin mësimin në auditor me angazhimin e pavarur të studentëve me detyra dhe projekte, të cilat vlerësohen në kuadrin e vlerësimit të vazhdueshëm, apo praktikrat dhe stazhet pranë institucioneve publike ose subjekteve private, kontribuojnë gjithashtu në ndërthurjen e dijes teorike me atë praktike për përmbushjen e këtij kriteri, çka rezultoi edhe nga vizita në institucion, diskutimi me studentët dhe stafin, si dhe analiza e dokumentacionit të paraqitur nga institucioni.</p> <p><i>[RVB Studime Religjioze; Ev. 22: Plani Mësimor]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Ky program ka një strukturë që përputhet me profilin e programit master i shkencave. Ajo ka marrë parasysh qasje të ngjashme metodologjike shkencore të universiteteve më të mira perëndimore (përfshirë edhe universitetin e Oxfordit). Lëndë të tilla janë: Studimi i feve abrahamike, Historia e krahasuar e religjioneve, Feja, Ligji dhe shoqëria, Pedagogjia e edukimit fetar.</p> <p><i>[Ev. 22: Plani Mësimor]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga analiza e raporteve të veprimtarive formuese dhe ato të formimit teorik dhe praktik, rezultoi se ka një ndarje 10% për lëndët bazë (ku përfshihet metodologjia e kërkimit shkencor), 45% të kurrikulës e zënë lëndët karakteristike; 20% e zënë lëndët me zgjedhje; 10% lëndët plotësuese (informatika, praktika profesionale); 15% tema e diplomës.</p> <p>Kjo ndarje është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe lehtëson transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve.</p>
	<p>Programi ofron mundësi të shumta në terren për praktika profesionale.</p> <p>Kjo ka rezultuar se fuqizon punësimin e studentëve në përfundim të programit, sidomos duke pasur parasysh natyrën e tij specifike dhe numrin relativisht të kufizuar të të diplomuarve.</p>




	<b>[Ev. 22: Plani Mësimor]</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<p>Silabuset përditësohen periodikisht. Në fillim të semestrit të çdo viti akademik, pedagogu i lëndës është i detyruar të ngarkojë në sistemin informativ Bedër Information System (BIS) planin (silabusin) e lëndës që jep bashkë me përditësimet e nevojshme, duke përcaktuar qartësisht literaturën e detyruar dhe literaturën ndihmëse, gjithashtu programi i lëndës dorëzohet edhe pranë koordinatorit të departamentit.</p> <p>Ky plan miratohet nga drejtuesi i departamentit.</p> <p>Kjo rezultoi edhe nga vizita në terren gjatë të cilës u kërkua krahasimi midis një silabusi në vite të ndryshme, çka u konstatua se ka ndryshime dhe përditësimet.</p>			
	<b>[Ev. 55: Syllabuset e Lëndëve të Programit]</b>			
<b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>Rezulton se emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve të programit të studimit është realizuar duke marrë në konsideratë përvojat pozitive të disa prej universiteteve më me eksperiencë në fushën e teologjisë dhe studimeve religjioze.</p> <p>Lëndët kanë vijimësi, çka i ndihmon studentët të integrojnë mirë konceptet teorike me ato praktike. Kjo garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet praktikave. Si përfundim, synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe kërkuese.</p>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Ky program studimi mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në shkencë teologjike, në master shkencor tjetër, ose në doktoraturë/ciklin e tretë.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka një studim të tregut të punës si dhe një analizë specifike për tregun e punës së këtij programi.</p> <p>Thithja e studentëve të diplomuar nga ky program është maksimale në tregun e punës dhe në vijim në ciklin e tretë të studimeve, për vetë numrin e vogël të të diplomuarve.</p>			
	<b>[Ev. 58: Studim Tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave Islame]</b>			
<b>Konkluzione</b>	<p>Lëndët e këtij programi ndërthurin qartazi objektivat e tyre mësimorë dhe akademike duke mundësuar arritjen e objektivave të programit.</p> <p>Ky program ka një strukturë që përputhet me profilin e programit master i shkencave.</p> <p>Thithja e studentëve të diplomuar nga ky program është maksimale në tregun e punës dhe në vijim në ciklin e tretë të studimeve, për vetë numrin e vogël të të diplomuarve.</p> <p>Në përfundim kriteret e këtij standardi janë përmbushur plotësisht.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Islame, si njësi kryesore përgjegjëse për programin, rezulton se ka ndërmarrë një sërë hapash për përshtatjen e programit me tregun e punës, i cili është specifik. Kjo është realizuar nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerë shtetërorë e privatë. Departamenti ka marrë pjesë në takime me tregun e punës të organizuara nga zyra e planifikimit dhe karrierës.</p> <p>Rezultoni e nevojshme gjithsesi që të institucionalizohen aktivitete vjetore si: Takime me përfaqësues të tregut të punës dhe/ose Panair i Punës (me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve në nivel Departamenti dhe/ose universiteti).</p> <p><i>[Ev. 75. Lista e institucioneve bashkëpunuese, Tab. 5; Ev. 66. Lista e Institucioneve me të cilat Bedër ka marrëveshje partneriteti]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoni se institucioni i ka përfshirë studentët që ndjekim programin në konsultime për përmirësimin e programit, për silabuset, lëndët dhe se ai ka reflektuar ndryshimet. Takimet me studentët janë periodike, gjithashtu studentët vlerësojnë edhe pedagogët e tyre në mënyrë anonime, përpara përfundimit të çdo semestri, duke sugjeruar përmirësime, të cilat në vijim reflektohen.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Rezultoni se njësia përgjegjëse ka përmirësuar programin (duke ndryshuar përmbajtjen ose emërtesën e lëndëve sipas nevojave), është në kontakt të vazhdueshëm me institucionet e kultit dhe shoqatat e tjera, si dhe me aktorë të tjerë specifikë për këtë program.</p> <p><i>[Ev. Vizita e GVJ në institucion]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Departamenti i Shkencave Islame, si njësi kryesore përgjegjëse për programin, rezultoni se ka ndërmarrë një sërë hapash për përshtatjen e programit me tregun e punës, i cili është specifik.</i></p> <p><i>Njësia përgjegjëse ka përmirësuar programin, duke ndryshuar përmbajtjen ose emërtesën e lëndëve sipas nevojave.</i></p> <p><i>Rezultoni se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Ky program studimi përcakton qartë prioritetet e studimit dhe objektivat e kërkimit shkencor brenda disiplinës së studimeve religjioze, sipas çdonjërit profil. Këto harmonizohen jo vetëm me programe të tjera brenda institucionit, por edhe me objektivat madhorë të tij, siç rezultojn nga Strategjia e Institucionit.  <i>[Ev nr.7 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në Studime Religjioze]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Departamenti i Shkencave Islame respekton lirinë akademike të personelit akademik, i cili jo vetëm organizon në mënyrë të pavarur mësimdhënien dhe metodologjinë specifike, por ka edhe një peshë specifike lirie gjatë vlerësimit të studentëve, brenda sistemit të vlerësimit të vazhdueshëm. Stafit është nxitur të marrë pjesë në veprimtari kërkimore shkencore. Kjo është gjithashtu pjesë e vlerësimit të performancës së tij nga Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani, si dhe nga Zyra e Burimeve Njerëzore.  <i>[Ev. Nr. 30 për anketat dhe vlerësimet; Ev. Nr. 31: Formulari i vlerësimit për stafin akademik; RVB]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Studentët janë aktivizuar nëpërmjet bashkëpunimeve me pjesëtarët e stafit akademik në konferenca të përbashkëta, punime shkencore, aktivitete kërkimore dhe projekte. Këto rezultojnë nga diskutimet me stafin dhe studentët, pas vizitës në institucion.  Rezultojnë se studentët e këtij programi dhe stafi pedagogjik kanë marrë pjesë në shkollën dimërore të zhvilluar në Izrael me fokus kryesor në lirinë e besimit dhe dialogun ndërfaqor.  <i>[RVB]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Pjesëtarët e Departamentit jo vetëm nxiten por edhe mbështeten për të zhvilluar aktivitete kërkimore, financiarisht. Gjithashtu ata i bashkëngjiten departamentit në projekte të ndryshme.  <i>[RVB; Ev. 72: Lista e trajnimeve të organizuara; Ev. 54: Të ardhurat dhe financime të ndryshme; Ev. 68: Buxheti i departamentit të Shkencave Islame]</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>Departamenti i Shkencave Islame respekton lirinë akademike të personelit akademik, i cili jo vetëm organizon në mënyrë të pavarur mësimdhënien</i>

	<i>dhe metodologjinë specifike, por ka edhe një peshë specifike lirie gjatë vlerësimit të studentëve, brenda sistemit të vlerësimit të vazhdueshëm. Stafi është nxitur të marrë pjesë në veprimtari kërkimore shkencore. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Institucioni mbështet projektet kërkimore shkencore përmes një sërë mekanizmeve, si nxitje dhe incentiva për të aplikuar për projekte, asistencë në aplikimin për projekte të kërkimit shkencor nëpërmjet një njësie të specializuar, incentiveve që lidhen me mësimdhënien në rastet e pjesëmarrjes në projekte, etj.  <i>[RVB; Ev. 72, Lista e Trajnimeve]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Rezulton se Departamenti është angazhuar në analiza për të tretë, studime dhe projekte me karakter kërkimor shkencor. Stafi është angazhuar si individualisht, në grup apo edhe përmes Zyrës së Kërkimit Shkencor. Stafi ka marrë pjesë në Erasmus+, Cost Action EU, etj.  Megjithatë nevojitet një angazhim më i fortë në kërkimin shkencor, duke e transformuar atë në një burim qëndrueshmërie financiare për institucionin përmes projekteve kuadër të kërkimit shkencor të BE-së dhe jo vetëm.  <i>[RVB; Ev. 9, Rregullorja e kërkimit shkencor; Ev. 72: Lista e trajnimeve të organizuara; Ev. 54: Të ardhurat dhe financime të ndryshme gjatë 3 viteve të fundit.]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Departamenti ka organizuar një konferencë të përvitshme studentore, duke përzgjedhur për publikim në revistat e fakultetit punimet më të mira të studentëve. Gjithashtu, njësia kryesore dhe departamenti organizon çdo vit akademik konferenca shkencore. Në kuadër të plotësisht të objektivave, departamenti ka organizuar disa leksione të hapura me pedagogë dhe profesionistë të fushave të ndryshme, si dhe shkolla verore dhe dimërore, ku studentët e programit dhe departamenti marrin pjesë.  <i>[Ev. 9, Rregullorja mbi kërkimin shkencor; Ev. 64, Plani i Aktiviteteve të Departamentit; RVB]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues	Duke pasur parasysh se konkurrenca e profesionistëve në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës është shumë e vështirë të matet me indikatorë

për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	sasiorë, mund të pohohet se bazuar në evidencat e ofruara nga institucioni për punësueshmërinë e të diplomuarve (në programet e tjera) teologjike, është mjaftueshmërisht e lartë, jo vetëm në tregun vendas, por edhe në diasporën shqiptare, ku ka nevojë të madhe për ekspertë teologë.  <i>[Ev. 58: Studim Tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave Islame]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Studimet religjioze nuk janë një profesion i rregulluar me ligj, prandaj ky kriter nuk mund të aplikohet.			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	Studimet religjioze nuk janë një profesion i rregulluar me ligj, prandaj ky kriter nuk mund të aplikohet.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni mbështet projektet kërkimore shkencore përmes një sërë mekanizmave, si nxitje dhe incentiva për të aplikuar për projekte, asistencë në aplikimin për projekte të kërkimit shkencor nëpërmjet një njësie të specializuar, incentivave që lidhen me mësimdhënien në rastet e pjesëmarrjes në projekte. Njësia kryesore dhe departamenti organizon çdo vit akademik konferenca shkencore. Bazuar në këto indikatorë, standardi rezulton plotësisht i përmbushur.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Nr. 219, Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-13423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

23

<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Mësimdhënia në këtë program studimi përfshin leksionet, seminarët, detyrat e kursit dhe praktikat profesionale. Leksionet bazohen në një silabus lënde dhe janë ndërtuar në mënyrë interaktive, siç rezultojnë nga diskutimet me stafin dhe studentët. Metodologjia e mësimdhënies është një ndërthurje mes qasjes interaktive në seminare dhe didaktikës teorike në leksione.</p> <p>Mësimnxënia vlerësohet përmes një sërë instrumenteve, përfshirë provimet, diskutimet në seminare, paraqitjes së projekteve individuale ose në grup, etj.</p> <p><b>[Ev. 22: Plani Mësimor, Ev. 55: Syllabuset e Lëndëve të Programit]</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik u përgjigjet nevojave të studentëve përmes kombinimit të metodave dhe pasqyrimin të tyre në silabuse. Gjithashtu studentët përfshihen përmes përfaqësuesve të tyre në parashtrimin e nevojave të tyre, janë pjesë e mbledhjeve të departamentit. Referuar takimit me studentët, përmenden raste kur studentët kanë sugjeruar ndryshime në silabus ose në mësimdhënie, të cilat janë marrë parasysh në vijim nga pedagogët dhe drejtuesi i departamentit. Këto plotësohen nga mekanizmi i vlerësimit të pedagogëve dhe stafit, ku parashtrihen në rubrika të posaçme sugjerimet e studentëve për përmirësimin e mësimdhënies. Metodatat alternative përfshijnë trajnime të fokusuar tek studenti, brenda dhe jashtë institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Institucioni ka mbështetur në vijim personelin akademik me trajnime të brendshme mbi kompetencat didaktike. Kjo ka qenë pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit (2018-2023). Gjithashtu institucioni ka mbështetur financiarisht stafin edhe me trajnime jashtë institucionit (brenda dhe jashtë vendit) përmes dedikimit të një buxheti të posaçëm për konferenca, trajnime brenda dhe jashtë.</p> <p><b>[Ev. nr. 72 Lista e trajnimeve të organizuara për stafin 2020-2022]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe</p>	<p>Ekspertiza e personeli akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi përputhet me lëndët të cilat ata zhvillojnë, bazuar në CV-të e konsultuara të stafit, të cilat përditësohen në mënyrë periodike. Fushat e njohurive të stafit pedagogjik lidhen me edukimin fetar, fenë dhe ligjin, filozofinë, psikologjinë, sociologjinë.</p> <p>Nga vlerësimi i evidencave të paraqitura vihet re se njësisia bazë është përpjekur të përfshijë interaktivitetin në mësimdhënie përmes projekteve të ndryshme të realizuara nga studentët, në kuadër të lëndëve të ndryshme, nëpërmjet individëve të ftuar si përfaqësues të agjencive, bizneseve dhe institucioneve publike dhe jopublike. Për të mundur realizimin sa më praktik dhe zbatues të koncepteve dhe konkretizimit të lëndëve, vizitat</p>



ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	studimore pranë institucioneve dhe bizneseve të ndryshme si dhe organizimi i praktikave profesionale për studentët, bëjnë të mundur përfshirjen, aktivizimin e studentëve dhe praktikimin e dijeve të marra gjatë leksioneve.			
<b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Përveç studentëve të cilët vlerësojnë në mënyrë periodike personelin akademik, edhe vetë institucioni është përfshirë në vlerësimin e formave dhe metodave të mësimdhënies. Vlerësimi është periodik dhe rezultatet janë transparente e i bëhen me dije pedagogut, duke zhvilluar me të një dialog të hapur dhe duke respektuar të drejtat e pedagogut. Përmirësimet e sugjeruara nga Drejtuesi i Departamentit dhe Dekani i bëhen me dije pedagogut dhe bashkë me të dakordësohet përmirësimi dhe afatet. Ky proces është gjithëpërfshirës dhe siguron ruajtjen e anonimatit.  <i>[Ev. nr. 33 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët; Ev. nr. 71 Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik]</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Struktura përgjegjëse në nivel institucional që promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Ajo koordinon dhe bashkërendon punën me Departamentin për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Organizon trajnime të herëpashershme dhe bashkëpunon me Drejtuesin e Departamentit për vlerësimin e stafit akademik. NJSBC dhe Departamenti mbështeten nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit.  <i>[Ev. nr. 18 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë Ev. nr. 40 Vendim i senatit për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Mësimdhënia në këtë program përfshin leksionet, seminarët, detyrat e kursit dhe praktikat profesionale. Personeli akademik në mësimdhënie ka gradat e duhura shkencore, kualifikimet e nevojshme si dhe ekspertizën që përputhet me lëndët të cilat ata zhvillojnë, bazuar në CV-të e konsultuara të stafit, të cilat përditësohen në mënyrë periodike. Nga vlerësimi i evidencave të paraqitura vihet re se Departamenti është përprjekur të përfshijë interaktivitetin në mësimdhënie përmes projekteve të ndryshme të realizuara nga studentët, në kuadër të lëndëve të ndryshme, nëpërmjet individëve të ftuar si përfaqësues të agjencive, bizneseve dhe institucioneve publike dhe jopublike. Për sa më sipër, vlerësohet se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht



<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Dokumenti zyrtar i institucionit ku paraqiten kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive është Guida e Studentit. Ajo detajon mënyrat e testimit sipas lëndëve dhe programeve, vlerëimin e njohurive dhe dijeve. Informationet mbi vlerësimin e njohurive gjenden edhe në rregulloren e pranimit.</p> <p>Vlerësimi ndahet në disa komponentë, si eseja, seminarët, provimet. Një formë tjetër e shtuar rezulton se janë edhe projektet në kuadrin e lëndëve të programit. Këto janë të përcaktuara në rregulloren e fakultetit dhe të pogramit të studimit.</p> <p>Nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët, rezulton se nuk ka një formë të vetme, të unifikuar të vlerësimit për të gjitha lëndët. Kjo është logjike dhe racionale, bazuar në natyrën specifike të disa prej lëndëve, sidomos ato metodologjike, që kanë nevojë për testim të ndryshëm njohurish.</p> <p><i>[Ev. nr. 43 Guida e Studentit; Evidenca nr. 41 Model Kontrate]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Rezulton se studentët janë plotësisht të informuar mbi metodologjinë e testimit të njohurive.</p> <p>Kjo ndodh në fillim të semestrit, gjatë javës së parë të leksioneve/seminareve dhe prezantimit të lëndës, si dhe gjatë procesit të informimit të studentëve përpara dhe gjatë regjistrimit të tyre në këtë program studimi.</p> <p><i>[Faqja e internetit të institucionit: <a href="http://www.beder.edu.al">www.beder.edu.al</a>]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Nga takimi me personelin akademik, rezulton se pedagogët përdorin një tërësi mekanizmesh vlerësimi për t'u dhënë mundësi studentëve që të shprehin dhe të paraqesin njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë lëndës përkatëse, përfshirë testime të ndërmjetme, projekte, detyra kursi, punë në grup, raste studimore, analiza, prezantime, aplikime në raste konkrete reale në bashkëpunim me biznese ose agjenci që operojnë në treg, dhe provime finale.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Rezulton se institucioni përmbush plotësisht këtë standard, pasi i ka zhvilluar të gjitha format e vlerësimit të njohurive të studentëve, sipas parimit të kontrollit të vazhdueshëm. Studentët janë plotësisht të informuar për format e vlerësimit të njohurive për çdo lëndë. Gjithashtu të gjitha kriteret e vlerësimit janë transparente në silabus, në format elektronik, në rregullore, etj.</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Testimi e vlerësimi i studentëve të këtij programi shtrihet në gjithë semestrin akademik.</p> <p>Departamenti ka përcaktuar dy periudha kohore të kushtuara për provimet: provimet e ndërmjetme (java e 8-të e semestrit) dhe provimet përfundimtare - finale (përfundimi i semestrit, java e 15-të dhe e 16-të e semestrit).</p> <p>Vlerësimi paraqitet në çdo silabus dhe përfshin njohuritë e përfutuara nga silabusi.</p> <p><i>[Ev. nr. 5 Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar Bedër]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Institucioni ka zhvilluar sistemin e brendshëm elektronik të testim-vlerësimit, BIS, ku komunikohen të gjitha vlerësimet dhe përmes të cilit depozitohen edhe esetë. Këto shmangin format e abuzimit dhe rrisin transparencën. Këtë institucioni e realizon nëpërmjet formave të testeve në platformën G-Suite.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Rezultoni se studentët testohen për njohuritë e përfutuara bazuar në silabusin e lëndës.</p> <p>Takimet me studentët treguan se ky kriter përgjithësisht respektohet dhe nuk ka pasur raste të shmangies prej kësaj.</p> <p>Provimet vlerësohen nga titullari i lëndës dhe/ose asistenti i tij.</p> <p><i>[Ev. nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë; RVB; Minutat e takimit me studentët nga vizita në institucion e GVJ]</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve shoqërohet me komente të qarta në një pjesë të posaçme. Në raste specifike, kur studentët kanë pikëpyetje ose paqartësi mbi vlerësimin, ata kanë të drejtën të bëjnë një kërkesë në sekretari, e cila i përcillet departamentit. Drejtuesi i departamentit ka të drejtën të ngrejë një grup vlerësimi për pikët, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i dytë dhe përfundimtar i studentit. Ky proces përfundon me shpalljen përfundimtarëve të pikëve për studentin. Pedagogu mund gjithashtu të shtojë kohën e nevojshme për përvetësimin e njohurive, nëse gjykon se për komponentë të veçantë të lëndës kjo është e nevojshme.</p> <p><i>[Ev. nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë; RVB; Minutat e takimit me studentët nga vizita në institucion e GVJ]</i></p>


<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Universiteti dhe njësitë përgjegjëse kanë marrë të gjitha masat e nevojshme, në kuptimin e ndërtimit të rregullave, por edhe procedurat e zbatimit të tyre, për të mos lejuar kopjimin në testime, përmes monitorimit të dyfishtë.</p> <p>Plagjiatuara është e dënueshme sipas Rregullores për disiplinën e studentëve. Rastet e dyshuara për kopje ose plagjiaturë trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Personeli akademik përgjegjës për punime të ndryshme detyrash dhe tezash, bën kontrollet e duhura të plagjiaturës me anë të platformave të disponueshme falas dhe me pagesë, përfshirë edhe G-Suite.</p> <p><i>[Ev. nr. 53 Rregullorja për disiplinën e studentëve]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e sistemit dhe kalendarin akademik, stafi akademik publikon rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale. Studentët kanë kohën e mjaftueshme për të bërë të ditur ankesat e tyre ndaj vlerësimit.</p> <p>Në fund të semestrit pedagogu i lëndës dorëzon dosjen e provimit, e cila është e plotë në përmbajtje, duke përfshirë fletët e provimit, fletë-përgjigje, një kopje të pikëve të provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave përfundimtare, sipas rregullores përkatëse.</p> <p><i>[Ev. nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Të drejtat e studentëve garantojnë në rregulloren e studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një ankesë me shkrim te zyra e sekretarisë mësimore, e cila i përcillet departamentit. Drejtuesi i departamentit ka të drejtën të ngrejë një grup vlerësimi për pikët, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i dytë dhe përfundimtar i studentit. Ky proces përfundon me shpalljen përfundimtarëve të pikëve për studentin. Pedagogu mund gjithashtu të shtojë kohën e nevojshme për përvetësimin e njohurive, nëse gjykon se për komponentë të veçantë të lëndës kjo është e nevojshme.</p> <p><i>[Ev. nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Për këtë ekziston një komision ad hoc, i cili ngrihet me vendim të departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Kjo procedurë parashikohet në rregulloren e studimeve përkatëse, dokumentohet dhe arkivohet pranë departamentit.</p> <p><i>[Ev. nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë]</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<i>Ky standard përmbushet plotësisht pasi rezulton se institucioni ka një rregullore të qarta për testimin dhe vlerësimin e njohurive. Ka procedura të qarta. Parashikon rastet e ri-vlerësimit pas ankimimeve. Garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin e tyre.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	<p>Ky program studimi u ofron studentëve njohuri, dije bazë dhe specifike në studime religjioze, sipas tre profileve të tij. Programi ka një komponent gjithashtu të fortë të aftësimit praktik përmes praktikave profesionale dhe atyre në kuadrin e lëndëve specifike. Institucioni ka edhe marrëveshje me shumë institucione për aftësimin profesional të studentëve (në sektorin publik dhe privat).</p> <p><i>[Ev. nr.7 Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në Studime Religjioze; Ev. nr. 36 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Ky kriter i këtij standardi është një sfidë për këtë program studimi, pasi duhet të ndërthuri teknologjitë e informacionit me studime religjioze (dialog ndërftar, Lidership, edukim fetar): thellimin e njohurive duke përdorur teknologjitë e reja.</p> <p>Kjo është realizuar duke ndërtuar një lidhje të fortë mes bibliotekave online dhe mësimdhënies në auditor.</p> <p>Përdorimi i gjuhës së huaj, kryesisht anglisht, por edhe turqisht e arabisht është i pranishëm në shumicën e lëndëve, sidomos sa i takon literaturës.</p> <p><i>[RVB; Ev. nr. 9 mbi kërkimin shkencor; Ev. nr. 44, Marrëveshja për akses në JSTOR]</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.	<p>Në fund të çdo semestri, personeli akademik identifikon arritjen e objektivave të silabuseve si dhe nxjerr përfundimet përkatëse për njohuritë dhe shprehitë e fituara, duke nxjerrë dhe konkluzionet e nevojshme për nevojat e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit. Studentët informohen rreth formave të zbatimit të njohurive dhe të aftësive të fituara, përmes praktikave profesionale në kompani apo institucione të ndryshme.</p> <p><i>[RVB]</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë	<p>Programet e lëndëve të këtij programi studimi përcaktojnë qartë kompetencat për t'u implementuar në praktikat profesionale dhe më tej në</p>

<p>kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>karrierën profesionale. Studentët kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme dhe e përdorin atë për të zhvilluar njohuritë e përfituara përgjatë leksioneve.</p> <p>Nëpërmjet lëndëve specifike, personeli akademik ka nxitur punën në grup, ka zhvilluar diskutimet teorike mbi teologjinë dhe aspekte të lidhshme të fetar dhe edukimit fetar, si dhe ka iniciuar një sërë projektesh për pjesëmarrje në mobilitete studimore (Erasmus +).</p> <p><i>[Ev. nr. 66 Lista e institucioneve me të cilat KU Bedër ka marrëveshje partneriteti për bashkëpunime; Ev. nr. 9 Rregullorja mbi kërkimin shkencor; Ev. nr. 64 Plani i aktiviteteve te departamentit]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë angazhohen në orë të hapura dhe seminare brenda strukturës së programit të studimit. Këto marrin formën e pjesëmarrjes në aktivitete shkencore të organizuara nga institucioni. Departamenti ka edhe një plan vjetor aktivitetesh, me leksione, seminare e workshope/konferenca.</p> <p>Një praktikë e zhvilluar në këtë drejtim janë seminarët “Kur librat flasin”. Një ekspert diskuton mbi vepra të ndryshme me qëllimin realizimin sa më mirë të misionit dhe vizionit të departamentit.</p>			
	<p>Gjithashtu, personeli efektiv dhe me kontratë angazhohet në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit, prezanton studime në konferenca dhe simpoziume, merr pjesë në workshope dhe zhvillon leksione në institucione ndërkombëtare në kuadër të Erasmus+ ose projekteve të tjera.</p> <p><i>[Ev. nr. 64 Plani i aktiviteteve te departamentit]</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Ndonëse ky është një program studimi teorik, studentët inkurajohen vazhdimisht për ide inovative, siç rezultoi nga takimi i GVJ-së me studentët e programit, sidomos përmes konferencave studentore, ose duke u bërë pjesë e projekteve/axhendës kërkimore të stafit akademik.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Ky program studimi rezulton se garanton plotësisht krijuesin e aftësive krijuese dhe zbatuese tek studentët, përmes pjesëmarrjes së stafit akademik dhe studentëve në aktivitete shkencore, konferenca, projekte, etj. Institucioni arrin të nxisë kësisoj zhvillimin e ideve inovatore.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi III.5**  
**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyese të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Ndonëse nuk ekziston një rregullore e vetme e diplomimit, ku të parashikohen detyrimet përmbyllëse, institucioni ka zgjedhur ta rregullojë këtë proces përmes Rregullores Themelore, Rregullores së Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë, dhe Rregullores së Programit. Ato saktësojnë detyrimet e çdo studenti për t'u diplomuar. Të gjitha këto janë publike në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p><i>[Ev. nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Departamenti, përmes drejtuesit të tij, cakton udhëheqësit e temave të diplomave dhe ndajnë materialet e nevojshme për mbylljen e detyrimeve. Universiteti bën të mundur publikimin e informacioneve rreth provimeve finale përmes faqes të tij online dhe sistemit elektronik të personalizuar të studentëve, siç rezultoi nga takimet në institucion.</p> <p><i>[Ev. nr. 55 Syllabus-et e lëndëve të programit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në kuadrin e këtij programi parashikohet një punim i detyrueshëm i tezës nga studenti. Kjo vendoset nga njësia përkatëse akademike. Punimi është i parashikuar si lëndë e semestrit të dytë dhe ka 18 kredite. Mbrojtja tezës kryhet nga një komision i posaçëm, përmes një procedure formale të standardizuar në rregulloren e studimeve dhe provimeve.</p> <p><i>[Ev. nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi akademik ndihmon studentët në përgatitjen e temës së punimit të diplomës, sipas propozimit të vetë studentit, dhe miratimit paraprak nga pedagogu udhëheqës. Nuk ekziston një procedurë formale për këtë proces, e tillë si, për shembull, një formular kërkesë për temën e diplomës dhe pedagogun. Megjithatë kjo e bën më elastik sistemin dhe mundëson një diskutim të ngushtë e të drejtpërdrejtë midis studentit dhe udhëheqësit. Udhëheqësi asiston studentin në të gjithë procesin e shkrimit të punimit të diplomës dhe metodologjisë shkencore të përzgjedhur, duke garantuar cilësinë e punimit. Ai ka të drejtën të miratojë ose jo punimin, përpara se të paraqitet para komisionit.</p> <p>Kjo gjë rezulton edhe nga diskutimet e GVJ-së me Drejtuesin e Departamentit dhe pedagogët e këtij programi studimi.</p> <p><i>[RVB; Minutat e vizitës së GVJ në institucion: Takimi me Drejtuesit dhe Pedagogët]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni ofron bibliotekën dhe aksesin në literaturë në shqip dhe ndërkombëtare, përmes platformave si QUESTIA, etj. për një punim sa më të plotë. Institucioni garanton aksesin e plotë të studentëve në këto burime literature. Gjithashtu asistohen studentët në rastin e matjeve empirike, pyetësorë, etj., me sistemet e nevojshme të përpunimit të të dhënave dhe asistencë teknike IT.</p>



	<i>[Ev. nr. 44, Marrëveshja për akses në JSTOR]</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studenti asistohet në punimin e diplomës nga një udhëheqës. Nuk ekziston një procedurë formale e këtij procesi, në kuptimin e raporteve të përjavshme të përparimit të studentit, por udhëheqësit janë të lirë t'u përgjigjen në mënyrë elastike nevojave të studentit. Ai/ajo vendos nëse studentit është gati të mbrojë para komisionit punimin e tij. Në përfundim të mbrojtjes së diplomës studenti vlerësohet me notë dhe pikë.			
	<i>[Minutat e takimit nga vizita në institucion me GVJ]</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Kur studentit plotëson të gjitha detyrimet, merr 120 ECTS, të gjitha notat i ka kaluese dhe ka përfunduar detyrimet sipas rregulloreve të institucionit, ai pajiset me diplomën dhe suplementin. Këto janë në formatet e licencuara dhe aprovuara nga MAS. Në përfundim të studimeve, me kërkesë prej tij, studentit pajiset me një kopje zyrtare, të vulosur, të programit të plotë të studimit të zhvilluar.			
	<i>[Ev. nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë]</i>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga vizita në institucion ekziston një dokumentacion i plotë i studentit në zyrat e arkivës dhe/ose sekretarisë mësimore. Ky program akreditohet për herë të parë.			
	<i>[Minutat e takimit]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Në përfundim, standardi përmbushet plotësisht, pasi konstatojmë se institucioni garanton një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve në përmbyllje të programit studimor. Institucioni rezulton se bën të mundur publikimin e informacioneve rreth provimeve finale, ofron bibliotekën dhe aksesin në literaturë në shqip dhe ndërkombëtare, udhëheqësi akademik ndihmon studentët në përgatitjen e temës së punimit të diplomës, sipas propozimit të vetë studentit, dhe miratimit paraprak nga pedagogu udhëheqës.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b> Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë	Ky program është një Master Shkencor, jo profesional. Kriteri nuk aplikohet



mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.									
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky program është një Master Shkencor, jo profesional. Kriteri nuk aplikohet								
<b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky program është një Master Shkencor, jo profesional. Kriteri nuk aplikohet								
<b>Konkluzione</b>	<i>Ky program është një Master Shkencor, jo profesional. Kriteri nuk aplikohet</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit	Nga shqyrtimi që GVJ i bëri dokumentacionit përkatës, nga vlerësimi i dosjeve dhe të dhënave mbi arsimimin dhe kualifikimin e stafit të programit, rezulton se personeli akademik që mbulon lëndët mësimore të programit ka fushë kërkimore në përputhje me këtë program studimi dhe veprimtari botuese e shkencore të lidhur me fushën e mësimdhënies.

<p>akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Angazhimi i stafit është në përputhshmëri me detyrat e objektivat e programit, duke përbushur kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>Nga shqyrtimi i pjesëmarrjes dhe kontributeve në aktivitete shkencore i pedagogëve që mbulojnë programin e studimit del në pah angazhimi i tyre në tematika që lidhen drejtpërsëdrejti me fushën kërkimore-shkencore të masterit në fjalë. Përmendim simpoziumin ndërfaqësor “Koncepti i paqes në këndvështrimin fetar”, organizuar nga Departamentit i Shkencave Islame, në bashkëpunim me Departamentin e Teologjisë dhe Kulturës së KU “Logos” dhe Institutin Katolik të Filozofisë e Teologjisë Shkodër me tematike mbi rolin e dialogut ndërfaqësor, institucioneve arsimore e liderit fetar në promovimin e bashkëjetesës e harmonisë sociale. Një tjetër veprimtari e rëndësishme shkencore ka qënë konferenca ndërkombtare “Religion and Culture in Conflict and Peace” në Winchester të Mbretërisë së Bashkuar, mbi rolin e besimit në ndërtimin e paqes dhe kulturës së pajtimit. Jane zhvilluar gjithashtu diskutime publike me temë mbi vlerat qytetare dhe vlerat e besimit si kontribues të tolerancës, mirëkuptimit dhe bashkëpunimit midis qytetarëve të shekullit XXI, etj.</p> <p>Për kualifikimin në vazhdimësi të personelit, institucioni zhvillon edhe trajnime që lidhen me realizimin e objektivave të tij strategjike dhe në funksion të realizimit të programit të studimit. Tematika e tyre orientohet në rritjen e cilësisë së mësimdhënies me në qëndër studentin, në çështje të menaxhimit e kulturës institucionale, të etikës në arsimin e lartë, të përditësimit të sylabuseve, të metodologjive bashkëkohore në mësimdhënien e mësimnxënien e gjuhës shqipe, të publikimit të artikujve në revista të indeksuara, etj.</p> <p><b>[Ev.72: Lista e trajnimeve të organizuara për stafin 2020-2022; Ev.16: CV-të e stafit akademik të angazhuar për programin; Ev.55: Sylabuset e lëndëve të programit; Ev.59: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë; Ev.76: Të dhënat përmbledhëse për stafin akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit]</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës, rezulton se mbulimi i ngarkesës mësimore për këtë program studimi, është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore të programit, duke realizuar mbi 70% të orëve në auditor.</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022, në këtë program studimi janë angazhuar 9 personel akademik me kohë të plotë dhe asnjë me kohë të pjesëshme. Ndërsa në vitin akademik 2022-2023, 8 personel akademik me kohë të plotë dhe 1 me kohë të pjesëshme.</p> <p>Në funksion të rritjes së cilësisë së zhvillimit të procesit mësimor, institucioni ka hartuar edhe udhëzues për politika të përmirësimit të cilësisë së programit dhe personelit akademik të programit, që përfshijnë zhvillimin profesional të personelit akademik, mundësinë e lëvizshmërisë së stafit jashtë për të sjellë përvojën më të mirë ndërkombëtare, motivim të</p>


	<p>personelit akademik për kërkim shkencor e inovacion, vlerësim të mësimdhënies dhe lëndës me tregues të posaçëm, etj.</p> <p><i>[Ev.20: Udhëzim për ngarkesën mësimore; RVB; Ev.16: CV-të e stafit akademik të angazhuar për programin; Ev.10: Politika e Përmirësimit të Programeve të Studimit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Në vizitën që GVJ zhvilloi pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, u njoh me dosjet e personelit akademik që mbulon programin e që përfshinin dokumentacionin e plotë, bashkë me kontratat e punësimit dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore.</p> <p>Institucioni e ka të dëshmuar dhe të garantuar qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.42: Guida e stafit; Ev.69: Lista e të dhënave të dosjes së stafit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Dokumenti i institucionit “Rregullorja për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit” disiplinon të gjithë procedurën lidhur me rekrutimin e përzgjedhjen e personelit. Në nenet përkatëse të kësaj rregulloreje përcaktohen kriteret e mënyrës së rekrutimit të stafit, të drejtat e detyrat e personelit akademik, promovimi i karrierës së stafit akademik, etj.</p> <p>Evidentimi i kërkesës për personel akademik realizohet nga Departamenti, i cili përcjell nevojat specifike për lëndë të caktuara në Dekanat dhe prej këtej, për miratim Rektorit. Kërkesa e miratuar i dërgohet për ndjekje Zyrës së Burimeve Njerëzore, që publikon vendin vakant në në faqen zyrtare të institucionit dhe/ose zyrës së punës.</p> <p>Nga biseda me drejtuesit e njësisë kryesore dhe asaj bazë si dhe mbështetur në dokumentacionin e shqyrtuar, rezulton se aplikohet një procedurë e rregullt e transparente edhe për punësimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor, si edhe atë administrativ. Sipas informacionit nga takimi me përgjegjësen e Zyrës së Burimeve Njerëzore, institucioni ndjek politika të rekrutimit të stafit nga të diplomuarit e vetë institucionit; për këtë qëllim studentë të programit të ciklit të dytë bëjnë praktikën pranë kësaj zyre, për punësimin e tyre në të ardhmen në njësitë administrative të institucionit. Rregulloret përkatëse të organizimit akademik dhe atij administrativ përcaktojnë detyrat dhe funksionet e organeve akademike si dhe kushtet e punësimit, përgjegjësitë dhe kompetencat e stafit administrativ.</p> <p>Kontrata e punës mund të jetë me afat dhe/ose pa-afat, në bazë të kategorisë së stafit akademik dhe kohës së punësimit të tij pranë KUB, në përputhje me rregulloren. Po kështu, të drejtat e detyrat sipas kategorisë së punës për stafin akademik janë të gjitha të përcaktuara qartë në dokumentat e mësipërme (statut e rregullore), bazuar në ligjin nr. 80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë</p>

	<p>në Republikën e Shqipërisë”, në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me arsimin e lartë jo publik në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Procesi i vlerësimit, qoftë institucional, ashtu edhe i vetëvlerësimit që rezultojnë se aplikohen në mënyrë sistematike, janë indikatorë të tjerë që tregojnë nivelin e zbatimit të të drejtave, detyrave e përgjegjësisë të stafit akademik në institucion.</p> <p><i>[Ev.12: Rregullorja për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit; Ev.14: Procedura e punësimit të personelit; Ev.50: Praktika e ndjekur për punësimin e personelit akademik]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës e nga njohja e dosjeve të personelit në Zyrën e Burimeve Njerëzore, rezulton se Departamenti Shkencave Islame, në përputhje me nevojat specifike, angazhon, gjatë procesit të zhvillimit të programit mësimor, personel me kualifikim akademik si “asistent-lektorë”, pranë titullarëve të lëndëve.</p> <p>Për vetë specifikën e tij, programi, që përmban kryesisht leksione dhe seminare të integruara, nuk aplikon orë të mirëfillta laboratorike.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev. 16: CV-të e stafit akademik të angazhuar për programin]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga biseda e informimi i GVJ në Zyrën e Burimeve Njerëzore mbi dosjet e personelit të angazhuar në programin e studimit, konkludohet se procedura kryhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Institucioni zotëron një bazë të dhënash të personelit, të cilat përditësohen çdo vit akademik me të dhënat e reja të veprimtarisë mësimore e shkencore të gjithsecilit.</p> <p>Në fillim të semestrit, me propozim të departamentit, aprovohet, sipas procedurës përkatëse, ngarkesa mësimore për çdo anëtar të stafit akademik.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.20: Udhëzim për ngarkesën mësimore]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera</p>	<p>Në kuadër të realizimit të praktikave studentore, sic rezulton nga biseda me drejtuesin e njësisë bazë, stafin akademik e studentët e programit të studimit si dhe nga dokumentacioni përkatës, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me KMSH dhe shkollat e mesme (Medresetë) si dhe me institucione të tjera fetare dhe biznese. Konstatohet se departamenti i kushton rëndësi bashkëpunimit me institucionet, jo vetëm për mundësinë e zhvillimit të praktikave dhe trajnimeve të ndryshme, por edhe për perspektivën e punësimit të studentëve pas diplomimit. Marrëveshje bashkëpunimi janë realizuar edhe me institucione homologe jashtë vendit e organizata të ndryshme fetare.</p>

specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Një pjesë e studentëve i zhvillojnë praktikat e tyre mësimore pranë KUB, duke u përfshirë në punime kërkimore, në bibliotekë, në Zyrën e Burimeve Njerëzore etj. GVJ është i mendimit se këto marrveshje, bazuar edhe në numrin e vogël të studentëve, janë të mjaftueshme për realizimin e praktikave mësimore; sidoqoftë mbetet e hapur mundësia për të lobuar më shumë nga ana e institucionit në zgjerimin e aksesit të studentëve të këtij lloji masteri në institucione shtetërore e private, pra edhe të mundësive për punësim të tyre.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.66: Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera për realizimin e praktikave profesionale; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame]</i></p>			
<b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<p>Mbi bazën e marrëveshjeve me institucionet pritëse për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, personeli mbikqyrës i tyre asiston studentët në përbushjen e detyrimeve e raportit përfundimtar të praktikës si dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për performancën gjatë zhvillimit të kësaj praktike.</p> <p><i>[RVB; Ev.63: Rregullore e praktikës profesionale]</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Nga shqyrtimi që GVJ i bëri dokumentacionit përkatës, nga vlerësimi i dosjeve dhe të dhënave mbi arsimimin dhe kualifikimin e stafit të programit, rezulton se personeli akademik që mbulon lëndët mësimore të programit ka fushë kërkimore në përputhje me këtë program studimi dhe veprimtari botuese e shkencore të lidhur me fushën e mësimdhënies.</i></p> <p><i>Mbulimi i ngarkesës mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore të programit, duke realizuar 70% të orëve në auditor.</i></p> <p><i>Institucioni zotëron dokumentacionin përkatës mbi procedurën e rekrutimit e përzgjedhjes së personelit si dhe një bazë të dhënash të personelit, të cilat përditësohen çdo vit akademik me të dhënat e reja të veprimtarisë mësimore e shkencore të gjithsecilit.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përbushjes</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në KUB dhe nga dokumentacioni mbi planimetrinë e godinës, rezulton se institucioni disponon një mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore. Në tërësi, këto mjedise fizike dhe të pajisura me mjetet e nevojshme u shërbejnë objektivave të formimit teorik, praktik dhe profesional të studentëve. Institucioni ka sallat e leksioneve, të seminareve, salla për aktivitete promovuese, salla për praktika lëndore/profesionale, laboratorë lëndësh, laboratorë informatike, salla interneti, salla biblioteka, mjedise për fotokopje, mjedis sportiv, zyrë informacioni për studentët, mjedise për veprimtari të qeverisë studentore, mjedise shlodhëse etj.</p> <p>Me një infrastrukturë të përshtatshme dhe të mirëpajisur, ato vihen në dispozicion, në përputhje me numrin e studentëve e natyrën specifike të programit të studimit.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; Ev.15: Mjediset e fakultetit/njësive bazë]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga vizita në institucion, rezulton se hapësirat e mjedisve (klasave, zyrave, sallës së kompjuterave, bibliotekës) dhe pajisja e tyre me elementët e nevojshëm (kompjuter, projektor, dërrasë interaktive (smart board), internet, karrige ortopedike etj ), nisur edhe nga numri i vogël i studentëve si dhe specifika e departamentit, përgjithësisht janë të mjaftueshme dhe efikase për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Mjediset janë të reja, të mirëmbajtura, ndërsa kondicionimi e ndriçimi i duhur japin komoditet dhe i shërbejnë efikasitetit të procesit mësimdhënës.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Objektet në shërbim të institucionit sigurojnë infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin me standarde bashkëkohore të procesit mësimor, në përputhje me natyrën specifike të programit të ciklit të dytë dhe moduleve përkatëse. Ky program studimi nuk është i natyrës teknike për të patur nevojë për laboratorë eksperimentalë. Sidoqoftë, kërkesat e moduleve të lëndëve në përmbajtje të programit, plotësohen në mjediset e vëna në dispozicion nga institucioni, të pajisura me infrastrukturën e teknologjinë e duhur mësimore didaktike, internet, kompjutera, smartboard, etj.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka siguruar dy laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale, sipas specifikës së programit të studimit.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; Ev.15: Mjediset e fakultetit/njësive bazë]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar</p>	<p>Për vetë natyrën e programit, si fushë e studimeve humanitare, praktikat profesionale të studentëve zhvillohen në institucionet dhe organizatat e ndryshme të teologjisë, institucioneve fetare e administrative në nivel</p>



<p>nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>qëndror e lokal, bazuar në një numër marrëveshjesh përkatëse që institucioni ka nënshkruar me këto të fundit.</p> <p>Në përputhje me profilin e programit, realizohen e vlerësohen si praktika profesionale të studentëve edhe ato pranë zyrave menaxheriale brenda vetë KUB.</p> <p>Përfaqësuesi i karrierës pranë departamentit, bën ndërlidhjen e bashkëpunimin me Zyrën e Planifikimit të Karrierës për realizimin eficient të praktikave profesionale të studentëve e lidhjen me tregun e punës.</p> <p><i>[Ev.37: Raporti vjetor i KU "Beder"; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame; Ev.60: Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera për realizimin e praktikave profesionale; Ev.47: Vendim i këshillit të departamentit për caktimin e përfaqësuesit të karrierës]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga vizita e GVJ në KUB dhe nga dokumentacioni mbi planimetrinë e godinës, rezulton se institucioni disponon një mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore. Në tërësi, këto mjedise fizike dhe të pajisura me mjetet e nevojshme u shërbejnë objektivave të formimit teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</i></p> <p><i>Hapësirat e mjediseve didaktike dhe pajisja e tyre, nisur edhe nga numri i vogël i studentëve si dhe specifika e departamentit, përgjithësisht janë të mjaftueshme dhe efikase për realizimin e programit të studimit.</i></p> <p><i>Për vetë natyrën e programit, si fushë e studimeve humanitare, praktikat profesionale të studentëve zhvillohen në institucionet dhe organizatat e ndryshme të teologjisë, institucioneve fetare e administrative në nivel qendror e lokal, bazuar në një numër marrëveshjesh përkatëse që institucioni ka nënshkruar me këto të fundit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në bibliotekën mësimore të institucionit, biseda me pedagogët e studentët e programit të studimit, rezulton se në dispozicion të studentëve institucioni ka vënë një numër të konsiderueshëm botimesh, tekste mësimore, literaturë ndihmëse. Fondi i bibliotekës përfshin 22600 tituj shkencorë, 26000 libra shkencorë, 166 monografi shkencore dhe 48 revista shkencore në gjuhët angleze, turke dhe arabe, ndërsa një literaturë e zgjeruar profesionale ofrohet në gjuhën shqipe.</p>

	<p>Për studentët e këtij programi studimi, që zhvillohet në gjuhën angleze, biblioteka ve në dispozicion si fond fizik ashtu edhe digjital në anglisht, literaturë që rekomandohet e mbulon të gjitha lëndët e programit.</p> <p>Biblioteka, me literaturën e gjerë që disponon e shërbimin online, i shërben pajisjes së studentëve me njohuri në fushën e Shkencave Islame, të ndërthurura me shkencat e tjera shoqërore të sociologjisë, filozofisë, psikologjisë së fesë, pedagogjisë etj.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; Ev.57: Udhëzim mbi funksionimin e bibliotekës; RVB-tab.17]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se KUB parashikon fonde për blerje të literaturës së specializuar, sipas profilit të departamentit përkatës. Në buxhetin vjetor të Departamentit të Shkencave Islame, figuron edhe një zë i titulluar “Shpenzime për literaturën e re”, ku parashikohet një fond i caktuar për përditësimin e literaturës me botime e publikime të viteve të fundit, në funksion të programeve të studimit. Ky program studimi ka të përcaktuar buxhetin e vet për literaturë të përditësuar.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; Ev.68: Buxheti i Departamentit të Shkencave Islame]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Salla e bibliotekës ze një hapësirë prej 120 m<sup>2</sup> dhe ofron 24 poste leximi. Ajo është e pajisur me 8 kompjutera, ofron shërbimin online si dhe mundëson akses për studentët gjatë aktivitetit universitar, duke garantuar mundësi të barabarta të shfrytëzimit të saj nga studentët e programit të studimit.</p> <p>Në “Guidën e Studentit” jepen informacione të hollësishme lidhur me bibliotekën e institucionit, shërbimin, faqen online të saj, funksionimin e hapësirat e shfrytëzimit të JSTOR.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB-tab.17; Ev.43: Guida e Studentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga biseda me stafin e studentët e programit, por edhe vizita në bibliotekë e dokumentacioni mbi të, rezulton se fondi fizik i saj, i përbërë nga një numër i konsiderueshëm titujsh shkencorë, libra e monografi shkencore, revista e materiale të tjera në gjuhë të huaj edhe shqip, plotëson nvojat e moduleve dhe veprimtarive mësimore të programit me tekste e literaturë ndihmëse. Organizimi i ndarjeve dhe skedimeve të bibliotekës sipas fushave të studimit lehtëson përdorimin e saj efiçent nga ana e studentëve. Sipas përgjegjëses së bibliotekës, ka një interes e frekuentim të vazhdueshëm nga ana e studentëve, si përgjatë procesit akademik në kryerjen e detyrimeve të lëndëve, seminareve, detyrave të kursit, etj, ashtu edhe realizimit të temave të diplomave apo pjesmarrjes së studentëve në aktivitete kërkimore-shkencore.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB]</i></p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>KUB ka marrëveshje me kontratë të rinovueshme vjetore për akses të plotë të stafit dhe studentëve në bibliotekën dixhitale JSTOR, një nga platformat më të mëdha akademike në botë, që ofron një numër të konsiderueshëm revista, gazeta, imazhe, artikujsh online, bazë të dhënash e 75 disiplinave të ndryshme.</p> <p>Studentët mund ta aksesojnë atë me anë të emailit institucional, duke patur kështu në dispozicion burime të shumta studimore në funksion të fushës së programit master.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; Ev.44: Marrëveshja për akses në JSTOR; RVB-tab.17]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e institucionit është e pajisur me programe kompjuterike dhe ka në përdorim 8 kompjutera që u japin mundësi studentëve t'i përdorin ato pa kufizim; database e bibliotekës gjëndet gjithashtu online, çka i ndihmon ata në gjetjen e literaturës së nevojshme.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Mjediset e bibliotekës janë të disponueshme nga ora 8.30 deri në orën 19.00 të mbrëmjes. Orari është afishuar në hyrje të bibliotekës. Në sezonin e provimeve, biblioteka qëndron e hapur edhe në fundjavë. Në bazë të sistemit të automatizimit, institucioni u ka dhënë mundësi studentëve që kërkesën për sigurimin e literaturës dhe regjistrimin ta bëjnë në formë elektronike. Nëpërmjet bibliotekës online JSTOR, në të cilën institucioni është abonuar, ofrohet sigurimi i materialeve të literaturës edhe në rrugë elektronike, duke patur akses në punime të shumta akademike, libra dhe material të nevojshme për zhvillimin e programit të studimit.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në bibliotekën e institucionit e biseda me përgjegjësen e saj, konstatohet se janë të dokumentuara të dhënat e përdorimit të fondit fizik dhe online të bibliotekës si nga stafi, ashtu edhe nga studentët. Sipas përgjegjëses së bibliotekës, ka një interes të vazhduar e në rritje të shfrytëzimit të materialeve të fondit fizik dhe online, në kushtet edhe të mundësive që institucioni u ka dhënë departamenteve për pasurimin e literaturës, sipas profilit të programeve, me botimet dhe publikimet më të fundit.</p> <p>Shfrytëzimi i bibliotekës është i lidhur ngushtë me rritjen e cilësisë e kërkesës së stafit akademik në drejtim të përdorimit të literaturës, detyrave e punimeve shkencore të studentëve në lëndët përkatëse të programit. Pedagogët e Departamentit të Shkencave Islame bëjnë përditësimin e titujve e teksteve sipas fushës përkatëse, me qëllim reflektimin e debatit akademik bashkëkohor.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; RVB; Ev.Mendimi I Dekanit]</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<p>Nga vizita e GVJ në bibliotekën mësimore të institucionit, biseda me pedagogët e studentët e programit të studimit, rezulton se në dispozicion të studentëve institucioni ka vënë një numër të konsiderueshëm botimesh, tekste mësimore, literaturë ndihmëse në gjuhë të huaj, ndërsa një literaturë e zgjeruar profesionale ofrohet në gjuhën shqipe.</p> <p>KU "Beder" ka marrëveshje me kontratë të rinovueshme vjetore për akses të plotë të stafit dhe studentëve në bibliotekën dixhitale JSTOR.</p> <p>Për studentët e këtij programi studimi, që zhvillohet në gjuhën angleze, biblioteka ve në dispozicion si fond fizik ashtu edhe digjital në anglisht, literaturë që rekomandohet e mbulon të gjitha lëndët e programit.</p> <p>KUB parashikon fonde për blerje të literaturës së specializuar, sipas profilit të departamentit përkatës, në funksion të programeve të studimit dhe në mënyrë të përditësuar.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Sipas RVB, sistemi i automatizuar që përdoret në KUB është Sistemi Informativ BIS Beder. Në dokumentin e hartuar nga institucioni, të titulluar "Udhëzues i sistemit informativ", pasqyrohet qartë funksionimi i tij, që mundëson që të gjitha veprimtaritë në institucion të bëhen në mënyrë të automatizuar. Nëpërmjet këtij sistemi administrohet i gjithë informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre: të dhënat personale; programi, e-mail, data e regjistrimit, gjuhët, edukimi i mëparshëm, statusi i regjistrimit të lëndëve, statusi i komunikimit me bibliotekën, të dhënat që lidhen me diplomimin, etj.</p> <p>Nëpërmjet sistemit informativ BIS, Zyra e sekretarisë mësimore administrohet të gjithë informacionin e duhur edhe për studentët e programit të studimit, nga regjistrimi deri në diplomim.</p> <p>Zyra e teknologjisë së informacionit e institucionit u shërben studentëve për çështje të IT që ata kanë nevojë e që lidhen edhe me përdorimin e hollësishëm dhe efektiv të sistemit informativ BIS.</p> <p><i>[RVJ; Ev:69: Udhëzues i sistemit informativ BIS]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit	<p>Në sistemin informativ BIS, të gjitha njësitë kanë llogarinë apo faqen e tyre, ku bëjnë veprimet që lidhen me profilin e punës së tyre.</p> <p>Në BIS ka llogarinë e vet edhe Zyra e Burimeve Njerëzore, që administrohet informacionin dhe dokumentacionin e personelit, nga procesi i aplikimit e deri në mbyllje të kontratës, për kategoritë e stafit akademik, ndihmës</p>

<p>ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>akademik, personelit administrativ, etj. Në zërat përkatës që kanë lidhje me personelin hyjnë të dhënat e përgjithshme, informacioni mbi formimin akademik, arsimimin, trajnimet, certifikatat e gjuheve të huaja, detajet e emërimit të personelit, publikimet dhe aktivitetet e ndryshme si dhe përditësimet e mundshme të të dhënave.</p> <p><i>[RVJ; Ev:69: Udhëzues i sistemit informativ BIS]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi informativ BIS, ku kanë llogarinë e tyre përkatëse njësitë e institucionit, personeli e studentët, mundëson në këtë mënyrë akses në dokumente e informacione për të gjithë stafin dhe studentët e programit të studimit. Zyra e IT e institucionit asiston për të gjitha çështjet teknike që lidhen me funksionimin e cilësinë e sistemit BIS.</p> <p><i>[Ev:69: Udhëzues i sistemit informativ BIS; Ev.42: Guida e stafit; Ev.43: Guida e Studentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Për vetë strukturën e tij, sistemi informativ BIS mundëson forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit midis personelit akademik dhe studentëve. Bëhet i mundur, psh, komunikimi me këshilltarin akademik, pedagogun/asistentin përkatës, sekretarinë studentore për çështje administrative etj, duke ofruar, në të gjitha rastet, të dhëna të përditësuara.</p> <p>Në guidën e studentit dhe guidën e stafit jepen informacionet e duhura lidhur me përdorimin e platformave online.</p> <p><i>[RVB-tab.17; Ev.42: Guida e stafit; Ev.43: Guida e Studentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi informativ BIS Beder garanton në kohë reale monitorim të veprimtarisë akademike dhe administrative, duke lehtësuar punën në institucion e duke garantuar korrektësi, mbi bazën e të gjitha udhëzimeve e procedurave që dalin nga senati dhe rektorati. Ky sistem jep mundësi, si për studentët, edhe për stafin akademik, të monitorohen në kohë reale pjesmarrja në mësim, nota, të dhënat e studentit, treguesit e lëndëve, etj.</p> <p><i>[Ev.45: Të dhëna të plota për platformën online]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>KU “Beder”, në faqen e tij zyrtare në internet <a href="http://beder.edu.al">beder.edu.al</a>, të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e tjera, i ka të publikuara në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Edhe informacionet që lidhen me Departamentin e Shkencave Islame gjenden në adresën <a href="http://www.isc.beder.edu.al">www.isc.beder.edu.al</a>.</p> <p><i>[RVB; Ev.45: Të dhëna të plota për platformën online]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Sistemi i automatizuar që përdoret në KUB është Sistemi Informativ BIS Beder.</i></p> <p><i>Nëpërmjet këtij sistemi, administrohen nga Zyra e e sekretarisë mësimore i gjithë informacioni i duhur për studentët e programit të studimit, nga</i></p>


	<p>regjistrimi deri në diplomim, si dhe realizohen kontaktet e studenteve me stafin pedagogjik.</p> <p>KUB, në faqen e tij zyrtare në internet <a href="http://beder.edu.al">beder.edu.al</a>, të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e tjera, i ka të publikuara në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin përkatës e sipas RVB, institucioni harton raport vjetor financiar të kostove të njësisë bazë e të detajuara sipas zërave që mbështetin, nga pikëpamja buxhetore, mbarëvajtjen e programeve të studimit me shpenzimet dhe të ardhurat përkatëse.</p> <p>KUB gëzon statusin e institucionit të arsimit të lartë jofitimprurës. Sipas statutit, ai mbështetet në kapitalin e themeluesit e pasuri të tjera të vëna në dispozicion prej tij, donacione të ndryshme, të ardhura të ndryshme të krijuara e burime të tjera të ligjshme financiare.</p> <p>Projekt-buxheti hartohet në fillim të cdo viti akademik, mbështetur në programin buxhetor afatmesëm trevjeçar dhe propozimet nga strukturat përkatëse.</p> <p>Lidhur me këtë program studimi, nevojat buxhetore të tij përfshihen në projekt-buxhetin e detajuar, që aprovohet nga mbledhja e Departamentit të Shkencave Islame.</p> <p><i>[Ev.2: “Statuti i KU “Beder”; Ev.68: Buxheti i Departamentit të Shkencave Islame; Ev. 54: “Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit”]</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi të ardhurat dhe financimet e institucionit për periudhën trevjeçare 2019-2022, konstatohen ndarjet sipas zërave përkatës, si grantet për kërkim dhe kontratat, konsulencat e shërbimet, tarifat për dhe gjatë shkollimit, donacionet etj.</p> <p>I detajuar në zëra e shifra përkatëse është edhe projekt-buxheti i hartuar nga njësia bazë, në funksion të realizimit të programit të studimit me të ardhurat e shpenzimet përkatëse për vitin akademik 2022-2023. Në të pasqyrohen të detajuara shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve e teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, për aktivitetet studentore të ndara në zëra përkatës, për konferenca, për bibliotekën e pasurimin e fondit të saj, për qëllime promovimi e marketing të detajuara në zëra përkatës, etj</p> <p><i>[Ev.68: Buxheti i Departamentit të Shkencave Islame; Ev. 54: “Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit”]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Sipas statutit të KUB, Bordi i Administrimit ka si përgjegjësi garantimin e qëndrueshmërisë financiare të institucionit, ndërsa Administratori i Kolegjit është përfaqësuesi ligjor për mirëfunksionimin financiar të tij.. Në mbledhjen e përbashkët të Senatit dhe Bordit të Administrimit, që zhvillohet në përfundim të çdo viti akademik, diskutohet edhe veprimtaria financiare e institucionit; Administratori paraqet aty raportin përkatës financiar.</p> <p>Në njësinë përgjegjëse, në rolin e administruesit dhe kontrollorit të veprimtarisë financiare të fakultetit është administratori përkatës</p> <p>Në planin strategjik të institucionit, ndër objektivat që lidhen me politikat dhe burimet financiare është theksuar sigurimi i standarteve të larta të përgjegjësisë, integritetit dhe kontrollit financiar, përditësimi i strategjive financiare afatshkurtra dhe afatmesme, duke vlerësuar periodikisht stabilitetin financiar.</p> <p>Institucioni kryen në mënyrë periodike vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes së tij financiare. Sipas statutit, institucioni i nënshtrohet edhe auditimit të jashtëm, sipas detyrimit ligjor të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave.</p> <p><i>[Ev.2: Statuti i KU “Beder”; Ev.8: Plani Strategjik Institucional i KU “Beder”; RVB-tab.18]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas RVB, fondacioni, pjesë e të cilit është KUB, harton raportet financiare sipas legjislacionit në fuqi, brenda afateve të përcaktuara dhe me pasqyra të hollësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p> <p>KUB i paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit çdo fund viti akademik raportin vjetor institucional, ku përfshihet buxheti i vitit të kaluar, projekt-buxheti i vitit të ardhshëm akademik si edhe projekt-buxheti afatmesëm.</p>



	<i>[RVB; Ev. 54: "Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit"]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	<p>Nga vizita në institucion e biseda me drejtuesit e njësisë përgjegjëse e njësisë bazë si dhe bazuar në RVB, rezulton se KUB ka tashmë një përvojë mbi dhjetë vjeçare të funksionimit të tij si IAL jofitimprurëse, ku ka dëshmuar qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit dhe mbështetje të donatorëve për ecurinë normale të programeve. Në dokumentin "Të ardhurat dhe financimet e ndryshme të tre viteve të fundit" pasqyrohen kapacitetet financiare të institucionit për periudhën përkatëse kohore, sipas aktiviteteve e zërave të përcaktuara, nga grantet për kërkim dhe kontratat, nga konsulentat dhe shërbimet; nga tarifat për dhe gjatë shkollimit, nga donacione, aktivitete siguroese, fondacionet, etj.</p> <p>Edhe në planin strategjik institucional përcaktohet si objektiv strategjik hartimi dhe mbështetja e politikave që sigurojnë qëndrueshmëri financiare. Shpërndarja e burimeve financiare e përdorimi i tyre në bazë të planit financiar është i bazuar në Standartet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkuara, sipas ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL", në ligjin nr.8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në ligjin nr.9224, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe aktet e tjera nënligjore të zbatimit të tyre.</p> <p><i>[Minutat e vizitës; Ev. 54: "Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit"; Ev.8: Plani Strategjik Institucional i KU "Beder"; RVB]</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>KUB gëzon statusin e institucionit të arsimit të lartë jofitimprurës. Projekt-buxheti i institucionit hartohet në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në programin buxhetor afatmesëm trevjeçar dhe propozimet nga strukturat përkatëse</i></p> <p><i>I detajuar në zëra e shifra përkatëse është edhe projekt-buxheti i hartuar nga njësia bazë, në funksion të realizimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>Institucioni kryen në mënyrë periodike vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes së tij financiare duke iu nënshtruar, sipas statutit, edhe auditimit të jashtëm.</i></p> <p><i>KUB, harton raportet financiare sipas legjislacionit në fuqi dhe i paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit çdo fund viti akademik raportin vjetor institucional.</i></p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
---	----------------------	-----------------------------	----------------------------	-----------------------------

				X
--	--	--	--	---

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i Statutit, Rregullores themelore e rregulloreve të tjera të brendshme si dhe dokumentacionit që lidhet me këtë program studimi, GVJ konstaton se programi, në të gjithë ecurinë e tij, disiplinohet dhe mbështetet nga një sërë aktesh rregullatore institucionale, që mbulojnë, në mënyrë të detajuar dhe të qartë, ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Politikat e procedurat e dokumentuara të institucionit u përgjigjen kërkesave të zhvillimit të programit, në përputhje me objektivat përkatëse.</p> <p><i>[Ev.2: Statuti i KU "Beder"; Rregullorja Themelore e KU "Beder"; Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë; Ev.6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Studime Religjose", etj]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në faqen zyrtare të KUB bëhen publike, për çdo vit akademik, kriteret e pranimit të studentëve edhe për programet e ciklit të dytë, në kushte të barazisë dhe të drejtave të njëjta për të gjithë. Përveç rregullores bazë të institucionit, është hartuar edhe rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë si dhe rregullorja e posaçme e programit të studimit. Në nenet përkatëse të tyre, evidentohen qartazi kriteret e pranimit të studentëve, kompetencat e nevojshme të zotërimit të gjuhës së huaj, vlerësimi i pranimit, njohja e krediteve të nevojshme, procedura e regjistrimit dhe organizimi i procesit mësimor, kushtet e transferimeve nga IAL të tjera, statusi i studentit e shumë çështje të tjera që lidhen me të gjithë procesin e zhvillimit të programit master, të njëjta për të gjithë studentët.</p> <p>Përveç informacionit nga institucioni, të interesuarit për programet e ciklit të dytë mund të marrin të dhëna e të ndjekin procedura regjistrimi dhe aplikimi edhe nëpërmjet portalit U-Albania.</p> <p><i>[Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit MSc "Studime Religjose"; Ev.5: Rregullorja Themelore e KU "Beder"; Ev.38: Politika e KU "Beder" për barazi gjinore, mundësi të barabarta dhe diversitet.]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit e biseda më drejtuesit e njësisë përgjegjëse e bazë ku ofrohet programi studimit, rezulton se institucioni</p>


<p>përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>publikon çdo vit akademik kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për programin. Si procedurë, institucioni i dërgon MAS kuotat përkatëse dhe kriteret, ndërsa i bën ato publike edhe në faqen zyrtare të internetit. Institucioni bashkëpunon me drejtoritë arsimore rajonale dhe nëpërmjet panairëve të karrierës që organizon në qytete të ndryshme, prezanton programet e studimit.</p> <p>Kriteret për pranimin e studentëve për programet e studimit të ciklit të dytë, për vitin akademik 2022-2023, të bëra publike në faqen zyrtare të institucionit e në përputhje me udhëzimet përkatëse, përmbajnë mesataren e programit bachelor në masën 70%, përshtatshmërinë e programit pararendës me atë për të cilin aplikohet bazuar në rregulloren specifike të programeve të ciklit të dytë, intervistën nga komisioni i posaçëm i vlerësimit i ngritur nga departamenti në masën 30% dhe mbrojtjen në nivelin B1 të gjuhës së huaj, sipas udhëzimit nr.52 të ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë, datë 3.12.2015.</p> <p>Ky program studimi ofrohet në gjuhën angleze dhe departamenti i ka përcaktuara e bërë publike të gjitha kushtet specifike për aplikim pranë këtij programi. Studentët aplikantë duhet të kenë kaluar me sukses provimin e nevojshëm të gjuhës angleze, të çertifikuar në nivelin B1 (APTIS, TOEFL; SAT, etj).</p> <p><b>[RVB; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Nëpërmjet faqes zyrtare të KUB mund të merret, në mënyrë të plotë e të qartë, i gjithë informacioni i nevojshëm lidhur me kriteret e procedurat e pranimit të studentëve e të dhëna të tjera që u referohen programeve të studimit që ofrohen. Njësitë kryesore, por edhe ato bazë që ofrojnë programet, kanë faqet e tyre të internetit, me informacione të nevojshme lidhur me kurrikulat, sylabuset e lëndëve, personelin akademik përkatës, etj.</p> <p>Studentët mund të marrin çdo informacion të hollësishëm mbi programin për të cilin janë të interesuar edhe pranë Zyrës së pranimit të studentëve apo sekretarisë së departamentit që ofron programin.</p> <p><b>[Ev.5: Rregullorja Themelore e KU "Beder"; Ev.43: Guida e Studentit]</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar nga GVJ, konstatohet se institucioni, përmes faqes së internetit, panairëve të arsimit dhe karrierës, broshurave e takimeve të drejtpërdrejta, bën të njohur ofertën vjetore të programeve që ofron, bashkë me tarifën e studimit e kriteret e pranimit. Si një institucion jofitimprurës, KUB ndjek politika pranimi që përputhen me infrastrukturën fizike dhe burimet njerëzore që ka në dispozicion.</p> <p><b>[RVB; Ev.43: Guida e Studentit; Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë]</b></p>



<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni ndjek politika mbështetëse për të gjithë studentët që janë pjesë e pakicave apo shtresave të marginalizuara</p> <p>Në Rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë, ka një nen të posaçëm mbi studentët me aftësi të veçanta, ku garantohet arsimimi i tyre si pjesë integrale e sistemit arsimor. Institucioni, ka marrë masa për lehtësimin e studentëve të kësaj kategorie edhe nga pikëpamja e infrastrukturës e shërbimeve mbështetëse. Edhe në “Guidën e Studentit” evidentohen këto masa e njësitë e infrastrukturës të përshtatshme për mbarëvajtjen e tyre gjatë procesit mësimor.</p> <p><i>[RVB, Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë; Ev.43: Guida e Studentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Institucioni i ka të dokumentuara dhe të publikuara kriteret e pranimit të studentëve të huaj. Në Rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë, parashikohet pranimi i studentëve të huaj, duke plotësuar kërkesat e procedurës së regjistrimit që ndiqet për studentët që frekuentojnë programet e nivelit të dytë, në përputhje me rregulloren. Studentët e huaj dhe ata që kanë mbaruar studimet universitare jashtë vendit, fillimisht duhet të kryejnë ekuivalentimin e diplomës, në përputhje me legjislacionin shqiptar të arsimit të lartë e pastaj të aplikojnë për t’u regjistruar në programin që ofron njësia bazë. Neni 23 i rregullores parashikon gjithashtu se, në raste të justifikuara, departamenti mund të kërkojë nga studenti i huaj edhe dokumenta shtesë. Këto kritere bëhen publike përpara çdo viti akademik në faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>Gjithashtu, lidhur me transferimet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve nga shtetet e tjera, institucioni ka hartuar “Rregulloren e transferimit të studimeve”, ku përcaktohen kriteret dhe procedurat e transferimit të studentëve nga universitete të huaja në programet e ciklit të dytë master pranë KUB. Pranë njësisë bazë që mbulon programin, krijohet komisioni ad hoc, ngritur nga Keshilli i departamentit dhe i përbërë nga pedagogë të angazhuar në ciklin e dytë të studimeve, i cili merret me të gjithë procedurën përkatëse. Kjo procedurë pasqyrohet edhe në rregulloren përkatëse të MSc në “Studime Religjioze”.</p> <p><i>[Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë; Ev. 25: Rregullorja e transferimit të studimeve; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit MSc “Studime Religjioze”]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni harton politika të veçanta që lidhen me ofrim bursash për studentët e programeve të ciklit të dytë të studimeve; vec bursave të ekselencës e të talentit, aplikohet edhe programi i Bursave sociale.</p> <p>Për kategoritë e përcaktuara të studentëve si: me status jetimi, pa kujdestari prindërore, me pamundësi ekonomike, me prindër të rënë në detyrë, me status invalidi, paraplegjiku, tetraplegjiku, ofrohen deri 100% bursë.</p>

	<p>Në Rregulloren Themelore të institucionit, në një nen të posaçëm, parashikohen edhe kushtet që studenti me bursë duhet të plotësojë për vazhdimësinë e akordimit të saj. Edhe tek “Guida e Studentit” evidentohen kushtet e mesatares që duhet të plotësojë studenti bursant gjatë periudhës së studimeve, për ta siguruar bursën edhe në semestrat pasardhës (mesatare 2.50 për studentët e ekselencës dhe 2.00 për ata me bursë sociale/ose talenti).</p> <p><b>[Ev.5: Rregullorja Themelore e KU “Beder; Ev.43: Guida e Studentit; RVB]</b></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Në faqen zyrtare të KUB bëhen publike, për çdo vit akademik, kriteret e pranimit të studentëve edhe për programet e ciklit të dytë.</i></p> <p><i>Njësitë kryesore, por edhe ato bazë që ofrojnë programet, kanë faqet e tyre të internetit, me informacione të nevojshme lidhur me kurrikulat, sylabuset e lëndëve, personelin akademik përkatës, etj.</i></p> <p><i>Institucioni bashkëpunon me drejtoritë arsimore rajonale dhe, nëpërmjet panairove të karrierës që organizon në qytete të ndryshme, prezanton programet e studimit.</i></p> <p><i>Ky program studimi ofrohet në gjuhën angleze dhe departamenti i ka përcaktuar e bërë publike të gjitha kushtet specifike për aplikim pranë këtij programi.</i></p> <p><i>Institucioni ndjek politika mbështetëse për të gjithë studentët që janë pjesë e pakicave apo shtresave të marginalizuara, ndersa i ka të dokumentuara dhe të publikuara edhe kriteret e pranimit të studentëve të huaj.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Institucioni disponon një sërë dokumentash e rregulloresh përkatëse me kriteret dhe procedurat që lidhen me përparimin akademik të studentëve përgjatë viteve të procesit mësimor. Edhe guida e studentit, në dispozicion për studentët, ofron një informacion të detajuar për të gjitha hapat e procedurat e ecurisë akademike të studentëve. Sekretaria mësimore gjithashtu, si njësi e posaçme administrative, ka për detyrë dhënien e çdo informacioni të kërkuar nga studentët, mbi aspekte të ndryshme të procesit akademik.</p> <p>Nga ana tjetër, departamenti cakton një person përgjegjës në rolin e këshilltarit akademik, për t’iu përgjigjur të gjitha nevojave për sqarime të</p>



	<p>studentëve e mbështetjes së tyre për probleme e vështirësi që mund të ndeshen gjatë procesit akademik.</p> <p><i>[Ev.43: Guida e studentit; Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Studime Religjose”]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar qartë kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme. Nenet e rregullores parashikojnë kushtet mbi plotësimin e njohurive formuese para hyrjes në program, mbi njohjen e krediteve për njohuritë e fituara më parë, etj.</p> <p>Një rregullore e posaçme e institucionit, lidhur me transferimin e studimeve, qartëson në mënyrë të hollësishme kriteret e këtij procesi, qoftë të transferimit të studentëve nga IAL të tjera apo brenda Kolegjit, mbi bazë kuotash të përcaktuara. Departamenti ngre një komision të posaçëm, me tre anëtarë, për gjykimin e vlerësimin e përmbushjes së kriteveve.</p> <p><i>[Ev.7: Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Studime Religjose”; Ev.25: Rregullorja e transferimit të studimeve]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Në një sërë dokumentesh të hartuara nga institucioni, si rregullorja themelore e tij, rregullorja e programit të studimit, rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë etj, janë përcaktuar qartësisht e në mënyrë të hollësishme kriteret e vlerësimit të dijeve të studentit, kriteret e kalimit në vitin pasardhës, e përmirësimit të mesatares së përgjithshme, kushtet e provimit e riprovimit, etj. Në dokumentin guida e studentit jepet gjithashtu një informacion i detajuar për aspektet e procesit të vlerësimit të dijeve.</p> <p>Nga ana tjetër, sqarimi mbi kriteret e procedurat e vlerësimit u bëhet i njohur studentëve që në javën e parë të prezantimit të lëndëve nga pedagogët përkatës. Silabuset e lëndëve, gjithashtu, përmbajnë kriterin detyrues të frekuentimit (studenti ka detyrimin të ndjekë jo me pak se 80% të aktivitetit mësimor kërkimor në auditor), kriteret e mënyrën e vlerësimit, nëpërmjet pikaverazhit përkatës të formave të kontrollit.</p> <p>Mënyrë tjetër informimi është edhe sistemi BIS, ku studentit ka të dokumentuar rezultatet në procesin mësimor, pikët e fituara e notat e lëndëve, mesataren etj.</p> <p><i>[Ev.5: Rregullorja Themelore e KU “Beder”; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit MSc në “Studime Religjose”; Ev.43: Guida e studentit; Ev.55: Sylabuset e lëndëve të programit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit pasqyrohen kriteret dhe procedurat lidhur me punimin e diplomës. Në një nen të posaçëm sqarohen rrethanat e penalizimit në rast plagjiature, ndërsa në një tjetër nen lidhur me vlerësimin e tezës, përcaktohen detajet e përgatitjes dhe shkrimit të tezës,</p>

	<p>afati i dorëzimit e kohëzgjatja e mbrojtjes, të dhënat mbi jurinë e mënyrën e vlerësimit, e drejta e kushtet e ankimimit te tezës, etj.</p> <p>Për aftësimin e studentit për kërkim shkencor dhe në funksion të përgatitjes së diplomës, në këtë program studimi master është parashikuar, si lëndë e detyrueshme formimi i përgjithshëm, “Metodat e kërkimit”, ku jepen njohuri bazë mbi metodat e avancuara të kërkimit shkencor.</p> <p><b>[Ev.7: Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Studime Religjoze”; Ev.55: Sylabuset e lëndëve të programit]</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Nga biseda në institucion dhe njohja e dokumentacionit, rezulton se KUB dhe në veçanti Departamenti i Shkencave Islame që ofron programet e ciklit të dytë, e kanë patur si objektiv të përhershëm informimin dhe publikimin e të dhënave për programet e studimit për të gjithë të interesuarit e studentët. Nëpërmjet takimeve të hapura, panairëve të organizuara për këtë qëllim, broshurave e katalogëve të publikuar në faqet zyrtare, në mënyrë periodike bëhen të njohura programet e ofruara, përmbajtja e tyre, diplomat e fituara dhe rëndësia e aksesit në tregun e punës.</p> <p>Për realizimin e këtyre aktiviteteve njohëse, institucioni mbështetet edhe në bashkëpunimin me drejtoritë arsimore rajonale.</p> <p><b>[Minutat e Vizitës; RVB]</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni disponon një sërë dokumentash e rregulloresh përkatëse me kriteret dhe procedurat që lidhen me përparimin akademik të studentëve përgjatë viteve të procesit mësimor.</i></p> <p><i>Nga ana tjetër, departamenti cakton një person përgjegjës në rolin e këshilltarit akademik, për t’iu përgjigjur të gjitha nevojave të studentëve e mbështetjes së tyre për probleme e vështirësi që mund të ndeshen gjatë procesit akademik.</i></p> <p><i>Silabuset e lëndëve, gjithashtu, përmbajnë kriterin detyrues të frekuentimit dhe kriteret e mënyrën e vlerësimit.</i></p> <p><i>Mënyrë tjetër informimi është edhe sistemi BIS, ku studenti ka të dokumentuar rezultatet në procesin mësimor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.3</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënimit dhe mundësitë e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Në “Ditët e Orientimit” që KUB organizon në javën e parë të fillimit të vitit të ri akademik, studentët njihen me personelin akademik dhe administrativ, me këshilltarët akademikë dhe marrin informacion të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p> <p>Personeli akademik, në detyrën e këshilltarit akademik, sipas udhëzuesit të posaçëm të miratuar nga institucioni dhe rregullores së organizimit akademik, ka të përcaktuara një sërë detyrash në ndihmë të studentëve, për mbarëvajtje të suksesshme gjatë procesit mësimor.</p> <p>Informacionet mbi programet janë të aksesueshme edhe në sistemin BIS e faqen zyrtare të institucionit.</p> <p><i>[Ev.49: Udhëzues i Këshilltarit Akademik; Ev.3: Rregullorja mbi organizimi akademik; Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Në mbështetje të studentëve, institucioni ka hartuar guidën e studentit, një udhëzues që u ofron atyre informacion të hollësishëm mbi procedurat e veprimtarisë mësimore. Gjithashtu, nëpërmjet sistemit BIS, studentët informohen për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Rregullorja e posaçme e programit të studimit përcakton objektivat formues specifike të programit, organizimin dhe gjuhën e studimit (gjuha angleze), listën e disiplinave dhe veprimtarive të tjera formuese me orët e kreditet përkatëse, njohjen e krediteve për njohuri të fituara më parë, nivelin e gjuhës së huaj e rastet e përjashtimit nga rregulli, etj.</p> <p><i>[Ev.7: Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Studime Religjose”; Ev.43: Guida e Studentit ]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në KUB janë ngritur struktura të posaçme në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës. Zyra e planifikimit të karrierës, pranë Drejtorisë së marrëdhënieve me studentin., funksionon në ndihmë të studentëve, për t’i ndihmuar ata në orientimin dhe këshillimin e karrierës. Ajo mundëson praktikën e tyre profesionale, sipas programeve e profileve, dhe ndjek nga afër procesin.</p> <p>Pranë saj, çdo department cakton këshilltarin për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar. Ai i informon ata mbi teknikat e kërkimit të punës, shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake, kërkon mundësi punësimi për studentët e diplomuar, organizon aktivitete që synojnë ruajtjen e marrëdhënieve me studentët pas diplomimit.</p> <p>Gjithashtu, pranë departamenteve funksionin edhe Bordi i Këshillimit të Karrierës, në përbërje të të cilit janë pesë anëtarë profesionistë, aktivë në profesionin e tyre, i cili u mundëson studentëve lidhjet me tregun e punës. Marrëveshjet e institucionit me organizata e biznese të ndryshme i shërbejnë jo vetëm zhvillimit të praktikave mësimore, por edhe mundësisë së punësimit të studentëve pas diplomimit.</p>

	<i>[Minutat e Vizitës; RVB; Ev.58: Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave Islame; Ev.47: Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e përfaqësuesit të karrierës]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Institucioni u ve studentëve në dispozicion informacion të detajuar e të përditësuar mbi zhvillimin e organizimin e studimeve. Në “Ditët e Orientimit” sqarohen çështje që lidhen me organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet që ofrohen në institucion, etj. Edhe në “Guidën e Studentit” shkruhet me hollësi mbi procedurat e komunikimit me institucionin, regjistrimin, tarifat e studimit, metodat e vlerësimit, provimet, kriteret e provimeve dhe riprovimeve, shërbimet që ofron institucioni në mbështetje të studentëve, infrastruktura në funksion të tyre, format e organizimit studentor, burimet online, etj.</p> <p>Gjithashtu, në fillim të semestrit, pedagogu përkatës bën të njohur përmbajtjen e tematikën e lëndës që do zhvillojë e që përmbahet në programin e studimeve, detyrimet e studentëve e kërkesat e tjera të lidhura me zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p><i>[Ev.43: Guida e Studentit; Ev.7: Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Studime Religjioze”]</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Institucioni ka ndërtuar një platformë të konsoliduar online, që i shërben procesit mësimor. Sipas RVB, studentët e KUB janë të informuar në kohë reale lidhur me programin e studimit përmes sistemit BIS (Beder Information System), i cili është i lidhur me llogarinë personale të studentit: <a href="mailto:gmail@beder.edu.al">gmail@beder.edu.al</a>.</p> <p>Në institucion funksionon edhe Zyra e IT, që është në dispozicion të studentëve për cdo nevojë e problematikë të aksesit të tyre në sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit.</p> <p>Komunikimi dhe informimi i studentëve kryhet edhe nëpërmjet sekretarive, pranë njësisë kryesore e asaj bazë.</p> <p><i>[RVB; Ev.43: Guida e Studentit; Ev.45: Të dhëna të plota për platformën online; Ev.35: Udhëzues i sistemit informativ BIS]</i></p>
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Institucioni u ve studentëve në dispozicion informacion të detajuar e të përditësuar mbi zhvillimin e organizimin e studimeve.</i></p> <p><i>Në “Ditët e Orientimit” dhe në “Guidën e Studentit” sqarohen çështje që lidhen me organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet që ofrohen në institucion, etj. në funksion të tyre, format e organizimit studentor, burimet online, etj.</i></p> <p><i>Nëpërmjet sistemit BIS, studentët informohen gjithashtu për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</i></p> <p><i>Në KUB janë ngritur struktura të posaçme në dispozicion të studentëve edhe për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Nga vizita e biseda e GVJ në zyrën e sekretarisë mësimore, njohja me regjistrin bazë e mënyrën e plotësimit të tij, rezulton se procesi i regjistrimit të studentëve në programin e ciklit të dytë master, mbajtja e statistikave të tyre e të studentëve të diplomuar, kryhet në përputhje me procedurat përkatëse, sipas rregullores.</p> <p>Zyra krijon dosjen personale dhe elektronike për çdo student, mban statistika të rregullta dhe, në mënyrë periodike, raporton mbi to në fund të çdo semestri. Zyra ka si detyrim jo vetëm përfshirjen e dokumentacionit të studentit në sistemin e menaxhimit të informacionit, por edhe përditësimin e këtij informacioni. Të gjitha procedurat që kryhen në Zyrën e sekretarisë mësimore bazohen në rregulloren e saj, ku përshkruhen me hollësi rregullat dhe detyrat e organizimit dhe funksionimit.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.26: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	<p>Nga njohja e GVJ me dokumentacionin në zyrën e sekretarisë mësimore, rezulton se ajo disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre. Gjithashtu, në procedurat që kryen, zyra ka edhe detyrimin për të dokumentuar rastet kur studenti mund të tërhiqet nga programi që ndjek, të largohet para përfundimit të tij, apo të mos e përfundojë me sukses vitin akademik. Këto të dhëna statistikore raportohen pranë njësisë përgjegjëse institucionale.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.39: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame]</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Të gjitha të dhënat statistikore të studentëve që lidhen me procesin mësimor në KUB menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit BIS, i aksesueshëm nga personat përgjegjës të sekretarisë mësimore dhe këshilltari akademik, në kuadër të kompetencave që ai ka. Gjithashtu, rregullorja e zyrës së sekretarisë mësimore parashikon, në përpunimin e të dhënave personale të studentëve, ruajtjen, administrimin dhe mbrojtjen e tyre, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>[RVB; Ev.26: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore]</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë	<p>Bazuar në dokumentacioni përkatës, rezulton se institucioni ka hartuar politika dhe procedura praktike për monitorimin dhe mirëfunksionimin e</p>

<p>gjithë njësisë përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>njësive përbërëse administrative. Nëpërmjet auditimeve të brendshme vlerësohet dokumentacioni dhe saktësia e informacionit që lidhet me studentët. Këto auditime, të realizuara nga grupet e punës të ngritura për këtë qëllim, synojnë evidentimin e kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë për çështjet sa më sipër, bazuar në rregulloret përkatëse të institucionit dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Ato i shërbejnë sigurimit të cilësisë në njësitë e tij përbërëse, në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p><i>[Rregullorja Themelore e KU "Beder"; Ev.51: Procedura për Auditimin periodik të brendshëm]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre reguesve.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit përkatës dhe nga biseda me drejtuesin e njësisë bazë që mbulon programin MSc në "Studime Religjose", konstatohet se, për këtë program, departamenti ka të detajuar informacionin mbi cilësinë dhe ecurinë e studentëve përgjatë viteve akademike 2021-2022 dhe 2022-2023, sipas profileve që masteri ofron (edukim e lidhshëm fetar si dhe dialog ndërfaqësor).</p> <p>Njësia harton periodikisht raporte analitike lidhur me ecurinë e procesit mësimor, cilësinë në hyrje e dalje të studentëve, shkallën e punësimit, si dhe masat për përmirësimin e mëtejshëm të objektivave të saj.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.39: Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve; Ev.36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave Islame]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga vizita e biseda e GVJ në Zyrën e sekretarisë mësimore, njohja me regjistrin bazë e mënyrën e plotësimit të tij, rezulton se procesi i regjistrimit të studentëve në programin e ciklit të dytë master, mbajtja e statistikave të tyre e të studentëve të diplomuar, kryhet në përputhje me procedurat përkatëse, sipas rregullores.</i></p> <p><i>Të gjitha të dhënat statistikore të studentëve që lidhen me procesin mësimor në KUB menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit BIS. .</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore</p>	<p>Bazuar në statutin e KUB, studentët kanë të drejtë të kenë këshillat e tyre studentore (në nivel kolegji e fakulteti), nëpërmjet të cilave ata mbështeten në të gjitha aspektet e jetës studentore e përfaqësohen pranë institucionit e autoriteteve të tjera në nivel kombëtar. Këshillat shprehin mendime e bëjnë propozime për çështje me interes të përgjithshëm të institucionit apo</p>



<p>dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>fakultetit përkatës për planet dhe programet e studimeve, për hapjen e programeve të reja, për rregulloret e veprimtarisë mësimore, për cilësinë e shërbimeve, për tarifat e shkollimit, për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. Ndërkaq, institucioni mbështet këshillat dhe financon veprimtaritë e tyre nga fondi i posaçëm i buxhetit të tij vjetor.</p> <p>Në rregulloren themelore të institucionit parashikohen kompetencat e Dekanatit të studentëve. Sipas këtij dokumenti, Dekani i studentëve është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me institucionin; ai koordinon aktivitetet social-kulturore të tyre dhe kryen detyrat në bashkëpunim me organet drejtuese. Dekani angazhohet në zgjidhjen e problemeve të studentëve në lidhje me jetën universitare, në koordinimin mes njësive akademike dhe administrative për çështje që prekin interes të studentëve, vlerëson e drejton aplikimet akademike, sociale, profesionale dhe administrative lidhur me jetën në mjediset universitare, kryen veprimtari në shërbim të rritjes së cilësisë së jetesës së studentëve e të aktiviteteve sociale të tyre.</p> <p>Sipas ligjit të arsimit të lartë, studentët janë përfshirë gjithashtu në senatin akademik të institucionit, tek NJSBC dhe në Komisionin e përhershëm të garantimit të cilësisë.</p> <p>Me vendim të Senatit Akademik, KUB i ka përfshirë studentët në këshillin e fakultetit dhe në këshillin e departamentit.</p> <p><i>[Ev.2: Statuti i KU “Beder”; Ev.5: Rregullorja Themelore e KU “Beder”]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga biseda e GVJ në Departamentin e Shkencave Islame me studentët e këtij programi studimi, si dhe nga dokumentacioni përkatës, rezulton se studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit akademik në forma të ndryshme, si: nëpërmjet pjesëmarrjes në mbledhjet e këshillave të njësive kryesore dhe bazë, në NJSBC, në grupet e punës gjatë procesit të akreditimit apo në vlerësimin e veprimtarisë së institucionit dhe punës së stafit akademik.</p> <p>Anketa studentore, që vlerëson cilësinë e shërbimeve që ofron institucioni, zhvillohet një herë në çdo vit akademik; kohën e kryerjes e përcakton NJSBC e institucionit.</p> <p>Dy herë në vit, përpara provimeve të fundit të çdo semestri, studentët plotësojnë anketat vlerësuese për zhvillimin e lëndëve dhe performancën e pedagogut, bazuar në rregulloren e posaçme të institucionit mbi anketat e vlerësimit. Në to jepen gjykime lidhur me realizimin e objektivave dhe tematikave të programit të lëndës, literaturën, ngarkesën e metodologjinë e lëndës, cilësinë e mësimdhënies, motivimin e vlerësimit nga ana e pedagogut, etj.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.30: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve; Ev.33: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët]</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Nëpërmjet pjesmarrjes në këshillat studentore, sipas statutit të KUB, mundësohet përfshirja e studentëve, me mendime e propozime, në procesin e vlerësimit të planeve e programeve të studimit e hapjen e programeve të reja, në përmirësimin e rregulloreve e veprimtarisë mësimore. Nga ana tjetër, pjesmarrja në mbledhjet e departamentit u krijon studentëve hapësirë për vlerësime dhe sugjerime të drejtpërdrejta lidhur me aspekte të ndryshme të procesit mësimor.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.2: Statuti i KU "Beder"]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Nga biseda e GVJ me studentët e programit të studimit, rezulton se njësia bazë, në mënyrë koherente, u krijon atyre mundësinë për të dhënë mendime e propozime mbi korrektësinë e stafit akademik në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve dhe, në përgjithësi, mbi integritetin e realizimit të procesit mësimor. Studentët vlerësuan se, si nga drejtuesit e departamentit, ashtu edhe nga ana e stafit akademik, ka gatishmëri e përgjegjësi për të reflektuar në raste ankimesh.</p> <p><i>[Minutat e Vizitës; Ev.33: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>KUB, bazuar në akte ligjore e nënligjore e udhëzime të posaçme, përfshin dhe angazhon studentët në organe vendimarrëse e këshilluese. Këshillat studentore (në nivel kolegji e fakulteti) shprehin mendime e bëjnë propozime për çështje me interes të përgjithshëm të institucionit mbi planet dhe programet e studimeve, hapjen e programeve të reja, rregulloret e veprimtarisë mësimore, cilësinë e shërbimeve, tarifrat e shkollimit, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. Në KUB, bazuar në ligjin e arsimit të lartë, studentët janë përfshirë në senatin akademik të institucionit, tek NJSBC dhe në komisionin e përhershëm të garantimit të cilësisë. Ata marrin pjesë në procesin e vlerësimit akademik në forma të ndryshme. .</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me</p>	<p>Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë të KUB, njësia kryesore shpall publikisht programet e akredituara që ofron, para fillimit të pranimeve. Në faqen zyrtare të internetit publikohet i gjithë informacioni i nevojshëm mbi përmbajtjen e tyre. "Guida e studentit" është një udhëzues i plotë në shërbim të informimit të</p>

<p>parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>studentëve, ndërsa brenda institucionit funksionojnë për këtë qëllim njësitë e posaçme administrative, si zyra e sekretarisë mësimore dhe sekretaria e departamentit.</p> <p>Nga ana tjetër, sipas rregullores themelore të institucionit, Dekani i studentëve ka, në statusin e tij të posaçëm, përgjegjësinë për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me institucionin. Ai angazhohet në zgjidhjen e problemeve të studentëve lidhur me jetën universitare, në koordinimin mes njërive akademike dhe administrative për çështje që prekin interesat e studentëve, etj.</p> <p>Riorganizimi i këtij programi studimi nga gjuha turke në atë angleze është gjykuar edhe nga optika e rritjes së mundësisë së punësimit, jo vetëm në Shqipëri, por sidomos jashtë saj, si edhe ndërkombëtarizimit të institucionit e përthithjes të studentëve të huaj. Nëpërmjet këtij masteri ne gjuhen angleze, studentëve u zgjerohet mundësia për studime të tjera pasuniversitare apo për doktoraturë jashtë vendit.</p> <p><i>[Ev.6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Ev.5: Rregullorja Themelore e KU “Beder”; Ev.43: Guida e Studentit; Ev.26: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të institucionit e RVB, në KUB funksionon një sistem eficient për informimin, këshillimin, ndjekjen e asistimin e studentëve përgjatë procesit mësimor. Takimet informuese, trajnimet apo udhëzuesit për stafin e studentët i shërbejnë drejtpërdrejt këtij qëllimi.</p> <p>Me vendim të posaçëm të senatit akademik të institucionit është miratuar udhëzuesi i këshilltarit akademik, i cili caktohet nga departamenti dhe është në dispozicion të studentëve për informimin dhe orientimin e tyre lidhur me programin, kurrikulën, personelin dhe infrastrukturën në dispozicion, mbi kriteret e kalimit në vitin pasardhës, sezonin e kushtet e riprovimeve, transferimet, etj. Koordinatori i departamentit për programet e ciklit të dytë ndjek ecurinë e procesit mësimor, ecurinë e praktikës, oraret e lëndëve e provimeve, procesin e mbrojtjes së tezave, etj, duke realizuar edhe komunikimin me njësinë bazë, personelin akademik dhe studentët për problematikat që kanë të bëjnë me ecurinë e programeve të studimit.</p> <p>Institucioni i informon studentët edhe në lidhje me procesin e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit.</p> <p><i>[RVB; Ev.49: Udhëzues i Këshilltarit Akademik; Ev. 48: Vendimi për caktimin e Koordinatorit të programeve Master; Ev.4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe</p>	<p>Sipas rregullores themelore të institucionit, pranë Dekanatit të studentëve është ngritur zyra e planifikimit të karrierës, pranë së cilës çdo departament emeron këshilltarin e planifikimit të karrierës, që ofron këshillim për studentët e regjistruar.</p>

<p>periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e planifikimit të karrierës, në bashkëpunim me departamentin, mundëson dhe ndjek nga afër procesin e praktikave profesionale të studentëve. Pranë çdo departamenti funksionon edhe Bordi i Këshillimit të karrierës, me anëtarë profesionistë, aktivë në profesionin e tyre; bordi u mundëson studentëve lidhjen me tregun e punës.</p> <p>Në kompetencat e këshilltarit të karrierës hyjnë: informimi i studentëve mbi organizimin e seminareve, të teknikave të aplikimit për punë, mënyrës së hartimit të CV dhe kalimit me sukses të intervistës së punës. Gjithashtu, këshilltari i karrierës kërkon mundësi punësimi për të gjithë studentët e diplomuar dhe organizon aktivitete që i shërbejnë ruajtjes së marrëdhënieve me studentët, pas diplomimit të tyre. Nëpërmjet këshillimit të karrierës, leksioneve të hapura, të ftuarve e seminareve profesionale, studentëve u krijohet mundësia të informohen hollësisht për mundësitë e punësimit, pas mbarimit të programit të ciklit të dytë.</p> <p>KUB ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi për punësimin eventual, pas diplomimit, të studentëve nga departamenti i Shkencave Islame; KMSH, medresetë e Shqipërisë, institucione të ndryshme në diasporë, si qendra shqiptare islame në Zvicër, SHBA, Gjermani, Itali, etj janë palë e këtyre marrëveshjeve.</p> <p><b>[RVB; Ev.5: Rregullorja Themelore e KU “Beder”; Ev.58: Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave Islame]</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nga vizita në institucion, sipas dokumentacionit përkatës dhe RVB, rezulton se KUB ka në strukturën e vet administrative zyrën e të diplomuarve, që funksionon në varësi të Dekanatit të studentëve. Zyra ruan e përpunon të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve, duke i vënë ato në dispozicion të organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> <p>Zyra e karrierës dhe zyra e të diplomuarve, si njësi institucionale administrative, hartojnë raporte periodike mbi punësimin e studentëve, trajnimin e tyre, mundësitë e tregut etj, duke i vënë këto të dhëna në dispozicion qoftë të studentëve, ashtu edhe të organeve drejtuese të institucionit.</p> <p>Departamenti i Shkencave Islame ka një rrjet të konsoliduar të kontakteve me ALUMNI, që vijnë nga 13 shtete të ndryshme e me të cilët departamenti krijon mundësi të herëpashërshme bursash studimi pasuniversitare jashtë, si dhe mundësi punësimi për të diplomuarit, brenda e jashtë Shqipërisë. Madje, për të stimuluar dhe institucionalizuar më shumë komunitetin ALUMNI, me propozim të Departamentit të Shkencave Islame, institucioni organizon cdo vit ndarjen e cmimit të nderit “H. Vehbi Dibra” që, prej tre vitesh, u është dhënë të diplomuarve nga ky department, të punësuar si mësues në medrese e në institucionet në varësi të KMSH.</p>
	<p>Siç rezulton nga dokumentacioni, lidhur me riorganizimin e programit të studimi nga gjuha turke në atë angleze, departamenti ka zhvilluar edhe një studim tregu për t’iu përshtatur profileve të ngjashme të studimeve</p>

	religjose në vendet perendimore, duke konkluduar në variantin aktual (me tre profilet: <i>dialog ndërjetar, lidhship fetar dhe edukim fetar</i> ).			
	<i>[Minutat e Vizitës; RVB; Ev.58: Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave Islame]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<p>Sipas dokumentacionit të institucionit e nga vizita e GVJ, në KUB funksionon një sistem eficient për informimin, këshillimin, ndjekjen e asistimin e studentëve përgjatë procesit mësimor.</p> <p>Takimet informuese, trajnimet apo udhëzuesit për stafin e studentët i shërbejnë drejtperdrejt këtij qëllimi. Në shërbim të studentëve është Dekanati i Studentëve, ndërsa nga departamenti, në dispozicion të tyre, caktohet këshilltari akademik dhe koordinatori i departamentit, me detyra të përcaktuara institucionale.</p> <p>Zyra e planifikimit të karrierës, në bashkëpunim me departamentin, mundëson dhe ndjek nga afër procesin e praktikave profesionale të studentëve, duke bashkëpunuar edhe me Bordin e këshillimit të karrierës.</p> <p>Per riorganizimin e programit të studimit nga gjuha turke në atë angleze, departamenti ka zhvilluar edhe një studim tregu për t'iu përshtatur profileve të ngjashme të studimeve religjose në vendet perendimore, duke konkluduar në variantin aktual (me tre profilet: <i>dialog ndërjetar, lidhship fetar dhe edukim fetar</i>.)</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Institucioni ka ndërtuar procese të qarta vetëvlerësuese, për të siguruar dhe përmirësuar cilësinë në bazë të fushës së studimit, të shkencave islame. NJSBC ka si kompetencë hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe hartimin e standardeve për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e cilësisë.</p> <p><i>[Ev. nr. 27 Udhëzim për metodat e mësimdhënies inovative]</i></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Mekanizmat përgjegjës janë zhvilluar nga struktura e NJSBC-së. Këto përfshijnë monitorimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Anketime me studentë për stafin akademik dhe lëndët e programit Master i Shkencave në Studime Religjioze. Komponenti i tretë i këtij kriteri përbëhet nga formulari i vetëvlerësimit që plotëson pedagogu. Gjithashtu kjo plotësohet nga vlerësimi i departamentit për çdo lektor. Vlerësimet bëhen edhe nga fakulteti, jo vetëm nga departamenti.</p>
	<p><i>[Ev. nr. 61 Formulari i vetëvlerësimit për stafin akademik; Ev. nr. 34 Formulari i vlerësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies; Ev. nr. 17 Raporti përmbledhës i vetëvlerësimit të departamentit; Ev. nr. 50 Praktika e ndjekur për punësimin e personelit akademik; Ev. nr. 12 Rregullorja për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik përmes anketimeve dy herë në vit dhe vlerësimeve për personelin akademik dhe atë jo-akademik. Vlerësimi bëhet për çdo lëndë dhe pedagog. Njësia bazë në vijim merr masa për përmirësimin e metodave të mësimdhënies që rezultojnë si pika kryesore nga studentët. Gjithashtu studentët kanë mundësinë e trajtimit të ankimimeve, bazuar në rregulloren e studimeve dhe provimeve në ciklin e dytë, Neni 36.</p>
	<p><i>[Ev. nr. 71 Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik; Ev. nr. 31 Formulari i vlerësimit për stafin akademik; Ev. nr. 33 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët; Ev. nr. 33 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët; Ev. nr. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC; Evidenca nr. 60 Lista me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera për realizimin e praktikave profesionale]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Të gjitha rezultatet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë, përfshirë raportet periodike, semestrale dhe vjetore, arkivohen dhe u bëhen me dije autoriteteve përkatëse të institucionit, si dhe publikohen online, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 13 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni promovon shembuj të praktikave të mira duke shpallur listën e stafit me performancën më të lartë në rang fakulteti.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në përfundim, institucioni rezulton se ndjek një politikë të sigurimit të cilësisë në përputhje me këtë standard duke përmbushur kriteret si ndërtimi i proceseve të qarta vetëvlerësuese, për të siguruar dhe</i></p>

	<i>përmirësuar cilësinë në bazë të fushës së studimit. Këto karakterizohen nga ekzistenca e mekanizmave monitorues, përfshirja e studentëve dhe transparencja.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në përmbushje të këtij kriteri, institucioni ka themeluar NJSBC-në, përbërë nga 5 anëtarë, nga të cilët 1 kryetar, 2 përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore (një për çdo fakultet), 1 përfaqësues i këshillit studentor dhe 1 ekspert i jashtëm. NJSBC është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë.  <i>[Ev. nr. 11 Politika e Cilësisë; Evidenca nr. 10 Politika e Përmirësimit të programeve të Studimit; Ev. nr. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC; Ev. nr. 18 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka ngritur dy komisione të përhershme të cilat janë të parashikuara në Statut. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të tyre është përcaktuar me rregullore të veçanta: Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit dhe Komisioni i Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet, Aplikimet dhe Inovacionin. Këto komisione vlerësojnë periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore. Institucioni ka hartuar Politika e Sigurimit të Cilësisë dhe Politika e Përmirësimit të Programeve të studimit. Në të dyja këto struktura krahas anëtarëve të tjerë janë të përfshirë edhe përfaqësues të këshillit studentor, dhe një ekspert i jashtëm.  <i>[Ev. nr. 70 Të dhëna për anëtarët e NJSBC (Tabela 24)]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që	Institucioni është akredituar përmes tre proceseve të akreditimit institucional, në vitin 2013 nga APAAL, në vitin 2017 nga agjencia britanike e akreditimit “Quality Assurance Agency”, në bashkëpunim me ASCAL, si dhe së fundmi nga ASCAL. Ky program studimi i riorganizuar në masën mbi 20 %, po i nënshtrohet akreditimit për herë të parë.

promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Krahas këtyre, në vlerësimet periodike institucionale përfshihen edhe ekspertët e jashtëm të cilët japin mendimin e tyre rreth ecurisë që ka ndjekur institucioni për garantimin e cilësisë.  <i>[Ev. Faqja zyrtare online e institucionit]</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Institucioni përdor instrumente të matjes së kërkimit shkencor, për të pasqyruar arritjet por edhe dobësitë e stafit akademik. Ato përfshijnë edhe sistemet online të publikimeve të stafit akademik.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni e përmbush këtë standard plotësisht pasi vlerësohet se ka plotësuar kriteret 1-4, duke themeluar NJSBC-në, duke rregulluar përbërjen e saj, duke përfshirë edhe ekspertë të jashtëm, duke pasqyruar në mënyrë periodike vlerësimin akademik dhe shkencor të stafit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Departamenti është përfshirë në vlerësimin e programit të studimit. Vlerësimi bëhet në formë të dokumentuar në çdo mbledhje, që shqyrton mbarëvajtjen e procesit mësimor. Në përfundim të vitit akademik, i gjithë stafi mbledhet dhe diskuton mbi veprimtarinë e departamentit, duke kontribuar edhe në përgatitjen e raportit vjetor. Sa i përket programeve të ciklit të dytë, Departamenti ngre në fillim të vitit Komitetin Shkencor, i përbërë nga tre anëtarë. Ky i fundit është përgjegjës për vlerësimin e programit të studimit. Komiteti Shkencor evidenton arritjet dhe dobësitë, sugjeron përmirësime të kurrikulës dhe detajon planin e masave për përmirësim. Rezultatet e Komitetit u bëhen të njohura autoriteteve përkatëse për vendimmarrje të mëtejshme (Neni 13 i Rregullore për Sistemin e Brendshëm të Cilësisë)  <i>[Ev. nr. 65 Udhëzimi mbi Procesin e Zhvillimit të Kurrikulës; Evidenca nr. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC]</i>



<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit të NJSBC-së përfshijnë rezultatet, arritjet, identifikimin e mangësive dhe masat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e rezultateve. Institucioni ka bërë publik planin strategjik 2018-2023 që synon ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe të studentëve për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë. Studentit dhe stafit akademik e administrativ kanë në dispozicion: Guidën e Studentit dhe Guidën e Stafit, ku shprehet qartë rëndësia e cilësisë dhe siguri i saj në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.</p> <p><i>[Ev. 42 Guida e studentit; Ev. 43 Guida e stafit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> <p><i>[Ev. nr. 21 Procedura mbi praktikën profesionale; Evidenca nr. 31 Formulari i vlerësimit për stafin akademik]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni përdor gjithashtu metoda të tërthorta për vlerësimin e programit të studimit, ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Anketa e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës që përmban aspekte si përmbajtja e lëndës, mësimdhënia dhe të nxënit, mënyra e vlerësimit, njohja me silabusin, etj.</li> <li>• Anketa vjetore e kënaqësisë së studentit ndaj institucionit ku vlerësohen të gjitha shërbimet e ofruara dhe merren edhe rekomandime nga studentët për këto shërbime.</li> <li>• Anketa vjetore e kënaqësisë së stafit akademik ndaj institucionit, ku merret vlerësimi dhe rekomandimet e stafit për shërbimet e ofruara.</li> <li>• Anketa vjetore e kënaqësisë së stafit administrativ ndaj institucionit ku merren vlerësimi dhe rekomandimet e stafit për shërbimet e ofruara në institucion.</li> <li>• Anketa me studentët e programit të studimit.</li> </ul>
	<p>Në bazë të vlerësimeve dhe rekomandimeve, merren masa për përmirësimin e shërbimeve dhe programit të studimit. Gjithashtu, prej vitesh njësia bazë konsultohet edhe me bashkëpunëtorët e jashtëm, duke përfshirë edhe lektorët me kohë të pjesshme të cilët po ashtu kontribuojnë me sugjerime mbi zbatimin e programit të studimit.</p>

	<i>[Ev. nr. 19 Anketa me studentët e programit të studimit; Evidenca nr. 66 Lista e institucioneve me të cilat KU Bedër ka marrëveshje partneriteti për bashkëpunime në fusha të ndryshme; Evidenca nr. 24 Anketa me të diplomuarit e programit të studimit]</i>			
<b>Konkluzione</b>	Standardi përmbushet, pasi plotësohen të gjitha kriteret e përcaktuara. Rezulton se institucioni nëpërmjet departamentit është përfshirë në vlerësimin e programit të studimit. Vlerësimi bëhet në formë të dokumentuar në çdo mbledhje, që shqyrton mbarëvajtjen e procesit mësimor. Institucioni përdor përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta vlerësimi.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi VI.4</b> Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Vlerësohet se institucioni ka garantuar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në strukturat përgjegjëse për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Në përbërje të NJSBC-së, ka përfaqësues të studentëve dhe ekspertë të jashtëm.  <i>[Ev. nr. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	NJSBC funksionon sipas rregullores së saj dhe ka të qarta detyrat dhe përgjegjësitë për individët, studentët dhe palët e tjera. NJSBC vepron në mënyrë autonome dhe ushtron detyrat e saj me përgjegjësi.  <i>[Ev. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative	Në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit (administrativ dhe akademik). Ata ofrojnë rekomandime dhe janë pjesë e procesit.  <i>[Ev. nr. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC; Ev. nr. 24 Anketa me të diplomuarit; Ev. nr. 42 Guida e stafit; RVB]</i>

dhe studentëve të programit të studimit.									
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	<p>Përfshirja e aktorëve të brendshëm bëhet gjithmonë duke respektuar integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie. Senati akademik ka për detyrë të garantojë respektimin e integritetit të të gjithë aktorëve të përfshirë në vlerësimin e cilësisë dhe të evitojë çdo lloj pabarazie apo diskriminimi ndaj të gjithë studentëve apo stafit akademik. Aktivizimi i personelit dhe studentëve respekton integritetin. Proceset ciklike të vlerësimit respektojnë integritetin akademik dhe shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Institucioni ka miratuar gjithashtu “Politikën për Barazinë Gjinore, Mundësi të Barabarta dhe Diversitet”</p> <p><i>[Ev. nr. 38 Politika e KU “Bedër” për barazi gjinore, mundësi të barabarta dhe diversitet]</i></p>								
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyer në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<p>Institucioni përfshin në sigurimin e cilësisë aktorë të jashtëm nëpërmjet strukturave përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë. Komisioni i Përhershëm dhe NJSBC-ja kanë në përbërjen e tyre një anëtar/ekspert të jashtëm. Institucioni për më tepër, organizon takime të vazhdueshme me profesionistë të fushave të programeve që ofron të cilët krahas ekspertizës informojnë edhe me dinamikat e tregut të punës me qëllim përcjelljen e tyre për ndryshime në programin përkatës. Edhe vlerësimi i brendshëm i programit përfshin përfaqësues të industrisë dhe të diplomuarve, të cilët japin vlerësime dhe mendime në lidhje me nevojat apo efikasitetin e njohurive të marra në program. Kjo përfshirje shprehet në politikën për përmirësimin e programeve të studimit, e cila e bën atë të detyrueshme.</p> <p><i>[Ev. nr. 28 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC; Ev. nr. 24 Anketa me të diplomuarit; Ev. nr. 42 Guida e stafit; RVB]</i></p>								
<b>Konkluzione</b>	<i>Standardi plotësohet pasi kriteret janë përmbushur plotësisht. Institucioni ka garantuar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Në përbërje të NJSBC-së, ka përfaqësues të studentëve dhe ekspertë të jashtëm.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtaria e NJSBC-së është transparente dhe mund të aksesohet publikisht në faqen e dedikuar të saj në <a href="http://qac.beder.edu.al">http://qac.beder.edu.al</a> . Studentët janë vazhdimisht të njoftuar në këtë faqe si dhe me email për të gjitha aktivitetet.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Të gjitha rezultatet janë të publikuar në faqen e internetit. Raportet e brendshme: <a href="https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem">https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem</a> Raportet e jashtme: <a href="https://qac.beder.edu.al/page/external-evaluation-reports">https://qac.beder.edu.al/page/external-evaluation-reports</a> Vendimet e BA <a href="https://qac.beder.edu.al/page/accreditation-board-decisions">https://qac.beder.edu.al/page/accreditation-board-decisions</a>			
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Të gjitha vlerësimet periodike shoqërohen me plan masash, ku Senati Akademik ngre grupe pune.  <i>[Websitet: <a href="https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem/">https://qac.beder.edu.al/page/raporte-te-vleresimit-te-brendshem/</a>]</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Siç rezultoi nga analiza e GVJ-së, raportimet e NJSBC-së përdoren në mënyrë efektive nga institucioni, duke i shpërndarë çështjet dhe ndjekur ato që kanë nevojë për përmirësim të vazhdueshëm.  <i>[Minutat e takimit]</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni organizon vazhdimisht takime informuese, trajnime me stafin dhe studentët. NJSBC-ja organizon seanca informuese me studentët dhe personelin e programeve të studimit me qëllimin ndërgjegjësimin e tyre për përfshirje aktive në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit  <i>[Faqja e NJSBC-së: <a href="http://qac.beder.edu.al/activities">http://qac.beder.edu.al/activities</a>]</i>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Veprimtaria e NJSBC-së është transparente dhe mund të aksesohet publikisht në faqen e dedikuar të saj ku ndodhen të gjitha raportimet e saj. Institucioni organizon në mënyrë periodike takime informuese me stafin dhe studentët. Ky standard vlerësohet i përmbushur.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Studime Religjose” me profile, “Dialog ndërfaqetare”; “Edukim Fetar”; “Lidership Fetar”, ofruar nga institucioni i arsimit të lartë Kolegji Universitar “Bedër”**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Ky program studimi, është unik dhe risi në ofertën akademike shqiptare, pasi reflekton interesat dhe përparësitë kombëtare të vendit për edukimin e tolerancës dhe bashkëekzistencës fetare, frymës së mirekuptimit fetar e kulturor, harmonisë e bashkëjetesës paqësore në shoqëri. [Standardi I.1, Kriteri 1].
2. Institucioni ka ndërmarrë një tërësi aktiviteteve shkencore në funksion të këtij programi studimi. [Standardi II.6; II.7; III.1 dhe III.4].
3. Transparenca dhe përfshirje efektive e studentëve në vlerësimin e procesit akademik. [Standardi II.5; III.1 dhe III.4].
4. Biblioteka me fondin e librave online dhe fizik është e pasur dhe në funksion të efektivitetit të procesit mesimor dhe thellimit shkencor të studentëve. [Standardi IV.3].
5. Me riorganizimin e programit MSc në “Studime Religjose” nga gjuha turke në atë angleze, departamenti ka forcuar profilin ndërkombëtar të institucionit dhe mundësinë e perthithjes së studentëve të huaj, krahas atyre nga trevat shqiptare dhe diasporës, duke rritur githashtu mundësitë e punësimit jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj. Nëpërmjet këtij masteri në gjuhën angleze, studentëve u zgjerohet mundësia për studime të tjera pasuniversitare apo për doktoraturë jashtë vendit. [Standardi V.6. Kriteri 1].

**Pika të dobta**

1. Pavarësisht se tregon elasticitet në vendimmarrje, nevojitet një standardizim i mëtejshëm i sistemit të praktikave studentore. [Standardi I.3].
2. Nevojë për formalizim dhe standardizim të mëtejshëm të sistemit të vlerësimit, duke unifikuar mënyrën e vlerësimit të studentëve, çka do të rriste transparencën dhe do të nxiste përmirësimin e procesit të mësimnxënies. [Standardi V.2, Kriteri 3].
3. Nevojë për identifikimin e burimeve të mëtejshme për projekte kërkimore-shkencore që lidhen me fushën e studimeve religjioze me profilet e saj, duke garantuar më tej qëndrueshmërinë financiare të programit, por edhe të institucionit. [Standardi II.7].
4. Nevojë për standardizimin e mëtejshëm të procesit të supervizimit të punimit të diplomës nga personeli akademik. [Standardi III.5, Kriteri 4].

**Rekomandime**

1. Standardizim i mëtejshëm i sistemit të praktikave studentore.
2. Standardizim i mëtejshëm i sistemit të vlerësimit të studentëve.
3. Rritje e pjesëmarrjes në projekte kërkimore-shkencore në fushën e studimeve religjioze me profilet përkatëse.
4. Të standardizohet procesi i supervizimit të punimit të diplomës nga personeli akademik.
5. Rritje e përpjekjeve për një promovim më efikas të këtij masteri, përse profili i tij është risi e unik në tregun e punës. Institucioni mund të angazhohet më shumë për promovimin e programit pranë

institucioneve shtetërore dhe private, ato fetare e të shoqërisë civile, duke argumentuar rëndësinë e nevojën e ekspertëve të fushës së studimeve religjioze, e krijimit të kushteve për akses punësimi pranë tyre.



**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in  
"Religious Studies", with profiles, "Interreligious Dialogue"; "Religious Education";  
"Religious Leadership", provided by the Higher Education Institution - University College  
"Bedër"**

**Strengths and affirmations**


1. The Master's Program in "Religious Studies", with the profiles Interreligious Dialogue, Religious Education, Religious Leadership, is unique and innovative in the Albanian academic system of higher education, as it reflects the country's national interests and priorities concerning the education of tolerance and religious coexistence, the spirit of religious and cultural good understanding, and the harmonious and peaceful coexistence in society. **[Standard I.1, Criterion 1]**.
2. The institution has undertaken a series of scientific activities closely related to religious studies. **[Standard II.6; II.7; III.1 dhe III.4]**.
3. There is transparency and student involvement in the academic process. **[Standard II.5; III.1 and III.4]**.
4. The institution library is rich with digital and physical books, thus helping in making more effective the learning and research process of the students. **[Standard IV.3]**.
5. The reorganization of the MSc program in "Religious Studies" from Turkish to English, has aimed to strengthened the international profile of the institution and the possibility of absorbing foreign students and those from the Albanian-speaking regions and from diaspora. On the other hand, it would help to increase the employment opportunities not only in Albania, but also abroad. Through this master program taught in English, students are given the opportunity for other postgraduate studies or for a doctorate thesis abroad. **[Standard V.6. Criterion 1]**.

**Weaknesses**

1. Despite a certain degree of elasticity in lecturers' decision-making proces, there is a need for a further standardization of the professional practice system of students. **[Standard I.3]**.
2. The students' evaluation system needs further formalization and stardardization, unifying the evaluation for all subjects, which would enhance transparency and would boost the improvement of learning process. **[Standard V.2, Criterion 3]**.
3. There is a need for the further identification of resources and funds for scientific research linked to religious studies, particularly religious studies, thus contributing to overall financial sustainability of the institution and of the Department. **[Standard II.7]**.
4. There is a need for further standardization of the supervision process of final thesis/diploma. **[Standard III.5, Criterion 4]**.

**Recommendation**

1. Further standardization of students' professional practices.
2. Further standardization of the evaluation system for all subjects.
3. Increase of external scientific funding oportunities through participation in scientific projects.
4. To standardize the process of supervision of the thesis by the academic staff.



5. Increasing efforts for a more efficient promotion of this master's degree, as its profile is unique and innovative in the labor market. The institution can be more committed to promoting the program to state and private institutions, religious and civil society, arguing the importance and need of experts in the field of religious studies and creating conditions for their access to employment.





**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				<b>X</b>
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				<b>X</b>
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				<b>X</b>
IV. BURIMET JERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				<b>X</b>
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				<b>X</b>
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>